




Republika e Kosovës * Republika Kosova * Republic of Kosova

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



Prishtinë, Mars 2013

Rr. Armend Daci Nr. 1
Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 (38) 240 252

Fax: +381 (38) 245 844

E-mail: ICMM@kosovo-mining.org

Web: www.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

PËRMBAJTJA

LISTA E TABELAVE	3
LISTA E FIGURAVE.....	4
LISTA E SHTOJCAVE TË BASHKANGJITURA	5
SHKURTESAT:	6
PARATHËNIE	7
1. PËRGJEGJËSITË DHE FUNKSIONET E KPMM-së.....	8
2. ORGANIZIMI I KPMM-së	9
2.1. Bordi	9
2.2. Drejtoria dhe Stafi Tjetër Profesional.....	9
3. AKTIVITETET E KPMM-së PËR VITIN 2012.....	11
3.1. Licencimi.....	11
3.1.1. Licencat për hulumtime gjeologjike (kërkim-zbulim)	12
3.1.2. Licencat e shfrytëzimit	15
3.1.3. Lejet për Aktivitetet e Veçanta	17
4. PROJEKTET E KPMM 2012.....	20
4.1. Përpilimi i Plansheteve të hartës Gjeologjike të Kosovës.....	20
4.1. Mbështetje KPMM-se për kryerjen e Analizave Gjeokimike 2010-2012.....	21
5. AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË INSPEKTORATIT	23
6. AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË GJEOLGJISË	24
7. FINANCAT	35
8. AKTIVITETET E TJERA.....	42
8.1. GIS-i (Sistemi i Informacionit Gjeografik).....	42
8.2. GJEODEZIA	43
8.3. DEPARTAMENTI LIGJOR.....	45
8.4. ADMINISTRATA.....	49
8.5. TEKNOLOGJIA INFORMATIVE	51
8.6. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM	52
8.7. PROKURIMI	54
9. PROBLEMET NË SEKTORIN MINERAR	55
10. SYNIMET PËR TË ARDHMEN	57

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Licencat/lejet e lëshuara për vitin 2012	11
Tabela 2: Licencat e lëshuara për hulumtim	12
Tabela 3: Numri i licencave për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale	15
Tabela 4: Licencat e shfrytëzimit të lëshuara në vitin 2012.....	15
Tabela 5: Numri i licencave për shfrytëzim sipas llojeve të lëndëve minerale	17
Tabela 6: Lista e lejeve per aktivitete të veçanta te lëshuara gjate vitit 2012	18
Tabela 7: Lista e lejeve të lëshuara per vitin 2012 për leje për aktivitete të veçanta	19
Tabela 8: Aplikacionet e kompanive për aktivitete minerare për 2012.....	25
Tabela 9: Statistika e raportimeve të kompanive për vitin 2012.....	27
Tabela 10: Rezervat e shfrytëzuara për material ndërtimor ne vitin 2012.....	27
Tabela 11: Paraqitje tabelare e rezervave të shfrytëzuara të linjitit gjatë vitit 2012	28
Tabela 12: Rezervat e shfrytëzuara të Fe-Ni sipas kompanive për 2012	29
Tabela 13: Rezervat e shfrytëzuara të Fe-Ni sipas viteve.....	30
Tabela 14: Rezervat e shfrytëzuara të xehes së Pb-Zn për 2012.....	31
Tabela 15: Rezervat e shfrytëzuara nga minierat e Trepçës nga 2005-2012	31
Tabela 16: Prodhimi i Pb-Zn sipas kompanive dhe viteve	32
Tabela 17: Prodhimi i Cr_2O_3	33
Tabela 18: Aprovimi i buxhetit në fillim të vitit 2012	35
Tabela 19: Aprovimi i buxhetit përfundimtar në vitin 2012	35
Tabela 20: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar në vitin 2012	36
Tabela 21: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për paga në vitin 2012	37
Tabela 22: Buxheti i planifikuar dhe i shpenzuar për mallra dhe shërbime në vitin 2012	38
Tabela 23: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për komunalë në vitin 2012.....	39
Tabela 24: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për Projekte Kapitale në vitin 2012	39
Tabela 25: Inkasimi i te hyrave për vitin 2012, sipas viteve	40
Tabela 26: Faturimi dhe inkasimi i te hyrave për vitin 2012	41

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Organogrami i KPMM-së.....	10
Figura 2. Licencat/lejet e lëshuara gjatë vitit 2012	12
Figura 3. Grafiku i lejeve të lëshuara gjatë vitit 2012	19
Figura 4. Harta gjeologjike e Planshetit të Drenasit në shkallë 1:25 000	20
Figura 5. Harta gjeologjike e Planshetit të Blinajës në shkallë 1:25 000.....	21
Figura 6. Shpërndarja e mineralizimeve të arit në territorin e Kosovës.....	22
Figura 7. Rezervat e shfrytëzuara të lëndëve minerale ndërtimore	28
Figura 8. Raporti në mes të planifikimit dhe shfrytëzimit të linjiteve për vitet 2005-2012	29
Figura 9. Realizimi në % i prodhimit të linjitit për vite	29
Figura 10. Paraqitje grafike e rezervave të shfrytëzuar të Fe-Ni sipas viteve	30
Figura 11. Sasia e prodhuar e Pb-Zn sipas viteve	32
Figura 12. Prodhimi i Pb-Zn sipas kompanive dhe viteve	33
Figura 13. Prodhimi i Cr ₂ O ₃ për vitin 2012	34
Figura 14. Aprovimi i buxhetit në fillim të vitit 2012	35
Figura 15. Aprovimi i buxhetit në fillim në vitin 2012	36
Figura 16. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar në vitin 2012	37
Figura 17. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për paga në vitin 2012	37
Figura 18. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për komunalin në vitin 2012.....	39
Figura 19. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për komunalin në vitin 2012.....	40
Figura 20. Faturimi dhe inkasimi i te hyrave për vitin 2012	41
Figura 21. Paraqitja grafike e kualifikimit të personelit të KPMM-së	50

LISTA E SHTOJCAVE TË BASHKANGJITURA

1. Lista e të gjitha licencave aktive
2. Lista e Rentës Minerare
3. Raporti i Kryeinspektorit të Minierave
4. Lista e kompanive që kanë obligime ndaj KPMM-së për vitin 2012
5. Lista e aktvendimeve për gjoba administrative
6. Lista e propozimeve për përmbarim

SHKURTESAT:

GIS	Geographical Information System (Sistemi Gjeografik i Informimit)
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
TI	Teknologjia Informative
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJQHAB	Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm
MF	Ministria e Financave
VoIP	Telefonia (zëri) përmes IP (internetit)
ICITAP	Emri i kompanisë që e ka implementuar projektin
ArcGIS	Emri i softuerit
AutoCAD	Emri i softuerit
APK	Agjencia Kosovare e Privatizimit

PARATHËNIE

Të respektuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, që sipas Ligjit për Minierat dhe Mineralet Nr. 03/L-163 i përgjigjet këtij Kuvendi, para jush paraqet raportin e punës së vet për periudhën Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, që sipas Ligjit për Minierat dhe Mineralet Nr. 03/L-163 i përgjigjet këtij Parlamenti, para jush paraqet raportin e punës së vet për periudhën njëvjeçare për vitin 2012.

Resurset minerale të një vendi, siç dihet, janë shtylla mbështetëse, mos të themi edhe kryesore për planifikim të zhvillimit ekonomik të një vendi, ndërsa Kosova fatmirësisht posedon shumë prej këtyre resurseve, në krahasim me sipërfaqen që ka dhe me numrin e banorëve, duke hyrë kështu në mesin e vendeve të pasura me resurse, të cilat janë mjaft të atraktive dhe të vlefshme për tregun botëror.

Raporti i punës përmban punën dhe aktivitetin e bërë në fushën e gjeologjisë - hulumtimit, xehetarisë - shfrytëzimit, përpunimit, rezultatet e arritura gjatë vitit, problemet me të cilat është ballafaquar ky rregullator gjatë punës së vet, si dhe objektivat për të ardhmen.

Në fushën e hulumtimit interesimi është mjaft i madh te mineralet metalike, energjetike, kurse te mineralet industriale dhe ato ndërtimore ka më pak të interesuar. Kur themi kështu çdo herë mendojmë në investime të jashtme.

Në fushën apo sektorin e Shfrytëzimit, mund të themi se dominon angazhimi për shfrytëzim të mineraleve që karakterizohen si materiale ndërtimore. Edhe pse ne si rregullator kemi dhënë/ lëshuar licenca për shfrytëzim të mineraleve metalike dhe atyre industriale, rezultatet nuk janë të kënaqshme deri tani.

Te sektori i përpunimit ka probleme me të cilat jemi ballafaquar edhe këtë vit, por mendojmë se duhet të ndërrohet qasja te këta përpunues.

Gjatë punës së vet, stafi i KPMM-së çdo herë është angazhuar në zbatimin e ligjit dhe rregulloreve përkatëse të fushës industriale të xehetarisë, duke u mbështetur në standardet më të larta të Bashkimit Evropian.

Gjatë vitit 2012, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ka bërë angazhim maksimal për luftimin e operatorëve ilegalë, të cilët me vite po i krijojnë probleme të mëdha këtij institucioni, por edhe të gjithë atyre që operojnë në mënyrë legale. Janë ndërmarrë masat më të rrepta për konfiskim të mekanizimit, për çka pastaj jemi ballafaquar edhe me probleme të shumta.

Komisioni i pavarur për miniera dhe minerale do të vazhdojë edhe me intensitet më të shtuar gjatë vitit 2013, që t'i eliminojë të gjitha ato që bien në kundërshtim me Ligjin për Minierat dhe Mineralet.

Vlen të theksohet se përkrahje të pakursyer kemi pasur nga Policia e Kosovës, kurse të institucionet gjyqësore, lëndët po presin në sirtarë edhe më tutje.

Deputetë të nderuar, ne si Bord i këtij Rregullatori, por edhe ekzekutivi me tërë stafin e vet do të angazhohemi maksimalisht që t'i përmbushim të gjitha detyrat e parashtruara sipas ligjit. Ju garantojmë se nuk do të kursejmë asgjë për të mirën e përgjithshme të vendit tonë.

ME FAT!

1. PËRGJEGJËSITË DHE FUNKSIONET E KPMM-së

Në përputhje me Ligjin për Minierat dhe Mineralet nr. 03/L-163, sipas nenit 58 të këtij Ligji si dhe rregulloret në fuqi, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale i dorëzon raporte të rregullta vjetore Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit kalendarik të cilit i referohet edhe ky raport.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale rregullon dhe mbikëqyrë:

- (a) Hulumtimin, shfrytëzimin dhe përpunimin e rregullt të resurseve minerale në Kosovë, në pajtim me ligjin në fuqi;
- (b) Shfrytëzimin e sigurt, optimal të resurseve minerale në të gjitha veprimet e shfrytëzimit në miniera dhe zvogëlimin e ndikimit të veprimeve të dëmshme në mjedis;
- (c) Zbatimin e standardeve ndërkombëtare për veprimtaritë minerare.
- (ç) Sigurinë gjatë hulumtimit, shfrytëzimit dhe procesimit-përpunimit të lëndëve të para minerale në pajtim me ligjin dhe rregulloret në fuqi si dhe me standardet e nevojshme në këtë fushë.

Funksionet e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale janë:

- (a) Zbatimi i politikave dhe strategjisë zhvillimore për sektorin minerar të përgatitura nga Qeveria e të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ;
- (b) Lëshimi, bartja, pezullimi dhe tërheqja e lejeve dhe licencave për hulumtim, shfrytëzim dhe për aktivitete te veçanta;
- (c) Lëshimi, bartja, pezullimi dhe tërheqja e lejeve lidhur me përdorimin e lëndëve plasëse në veprimtarinë minerare;
- (ç) Mbikëqyrjen e punimeve dhe aktiviteteve minerare, për zbatimin e mbrojtjes dhe sigurisë në punë;
- (d) Kryerja e raporteve profesionale lidhur me aksidentet, avarit që mund të ndodhin në miniera dhe aktivitetet tjera minerare dhe veprimet e domosdoshme që nevojiten të ndërmerren si pasojë e këtyre;
- (e) Krijimi dhe mirëmbajtja e Bazës së të Dhënave për titullarët e mineraleve dhe të drejtave për shfrytëzimin e resurseve minerale,
- (f) Ofrimi i ndihmës teknike Qeverisë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me minierat dhe mineralet në Kosovë, nëse një gjë e tillë kërkohet nga Qeveria dhe të tjerët.

2. ORGANIZIMI I KPMM-SË

2.1. Bordi

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale përbëhet nga Bordi (“Bordi”), i cili i ka pesë anëtarë.

Të gjitha kompetencat e komisionit i ka Bordi i KPMM-së. Bordi mund t’i delegojë funksione të caktuara Drejtorit, përveç atyre që i janë dhënë në pajtim me ligjin nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet

Bordi i KPMM-së, përveç takimeve të rregullta, me kërkesë të Drejtorit apo të ndonjërit prej anëtarëve të bordit organizon edhe takime tjera. Anëtarët e bordit janë në marrëdhënie të rregullt pune në KPMM dhe realizojnë detyra të përditshme në përputhje me ligjin në fuqi.

Për marrjen e një vendimi në bord, Drejtori dhe stafi tjetër profesional përgatisin dhe shqyrtojnë kërkesat veç e veç sipas departamenteve, pastaj përmes takimeve të para-bordit bëhet seleksionimi i kërkesave që i plotësojnë kriteret për t’u përcjellë për bord, në përputhje me ligjet në fuqi.

Brenda KPMM-së funksionon edhe Departamenti i Inspektoratit të Minierave i cili rregullohet në pjesën XI të ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, që udhëhiqet nga Kryeinspektori i cili duhet të zgjidhet nga Qeveria dhe ti raporton bordit të KPMM-së, Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2.2. Drejtoria dhe Stafi Tjetër Profesional

KPMM për vitin 2012 ka pasur të aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës 79 pozicione për staf. Drejtori është përgjegjës për të gjitha çështjet ekzekutive brenda KPMM-së, i cili bënë organizimin e takimeve të bordit, përgatitjen e raporteve sipas kërkesave për mbledhjen e bordit dhe merret me ekzekutimin e vendimeve të Bordit.

Në kuadër të KPMM-së funksionojnë këto Departamente: Inspektorati, Gjeologjia, Gjeodezia, GIS, Administrata, Financat, Prokurimi, TI, Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe Departamenti Ligjor.

Më poshtë kemi paraqitur strukturën Organizative të KPMM-së për vitin 2012.

3. AKTIVITETET E KPMM-së PËR VITIN 2012

KPMM në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional ka realizuar takime të shumta me institucione tjera: Ministria e Punëve të Brendshme (Policinë e Kosovës), Kryeprokurorin e shtetit, Komunitet e Kosovës, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Agjensionin për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Agjencia Kosovare e Pronës. Bashkëpunimi me këto institucione ka rezultuar me firmosjen e shumë memorandumeve të mirëkuptimit, të cilat kanë pasur për qëllim koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta me qëllim të zgjidhjes së problemeve të ndërsjella.

3.1. Licencimi

Gjatë vitit 2012 janë mbajtur **19** takime të Bordit në të cilat janë shqyrtuar **297** kërkesa për licenca dhe leje (në këtë numër janë përfshirë kërkesat e kompanive që janë shqyrtuar më tepër se një herë si dhe kërkesat e kompanive të pranuar para vitit 2012), ku prej tyre kanë qene:

- 168 kërkesa për Licenca të hulumtimit,
- 65 kërkesa për Licenca të shfrytëzimit,
- 64 kërkesa për leje dhe aktivitete të veçanta,

Bordi i KPMM-së gjatë takimeve të mbajtura gjatë vitit 2012, përveç kërkesave të pranuar gjatë vitit 2012 ka shqyrtuar edhe kërkesat e pranuar në vitet paraprake

KPMM-ë gjatë vitit 2012 ka pranuar gjithsej **133** kërkesa për licenca të hulumtimit dhe shfrytëzimit, si dhe **33** kërkesa për leje për aktivitete të veçanta, prej tyre:

- Kërkesa për Licenca të hulumtimit – **91**.
- Kërkesa për Licenca të shfrytëzimit – **42**.
- Kërkesa për leje për aktivitet e veçanta – **33** (separacione **29**, baze betoni **3**, baze asfalti **1**).

Pas procedimit të të gjitha aplikacioneve të lartcekura sipas procedurave të parapara me rregullativën ligjore në fuqi janë lëshuar **98** Licenca dhe Leje. Prej tyre janë **45** licenca për hulumtim dhe **40** licenca për shfrytëzim, si dhe **13** Leje për aktivitete të veçanta (baze asfalti **1**, baze betoni **2**, separacione **10**) – shih tabelën në vijim.

Pra, Bordi i KPMM-se gjatë vitit 2012 gjithsejtë ka shqyrtuar **297** kërkesa-aplikacione të Hulumtimi kanë qenë **168** për hulumtim, **65** për shfrytëzim si dhe **64** për aktivitete të veçanta.

Tabela 1: Licencat/lejet e lëshuara për vitin 2012

Nr. Rendor	Lloji i licences	Numri i licencave të aprovuara
1	Licenca për hulumtim	45
2	Licenca për shfrytëzim	40
3	Leje për aktivitete të veçanta	13
	Total	98

Ndryshimi ne mes te aplikacioneve dhe licencave te aprovuara është se kërkesat për licenca nuk i kane plotësuar kushtet për licencim




Figura 2. Licencat/lejet e lëshuara gjatë vitit 2012

3.1.1. Licencat për hulumtime gjeologjike (kërkim-zbulim)

“Licencë për hulumtim” nënkupton autorizimin zyrtar me shkrim të lëshuar nga KPMM në bazë të pjesës III të Ligjit Nr. 03/L-163 mbi minierat dhe mineralet.

Licenca për hulumtim të mineralet ndërtimore lëshohet në afat jo më shumë se 2 vite. Vlen për një zonë që nuk është më e madhe se 250 ha. Mund të vazhdohet edhe për një periudhë kohore maksimale prej 2 viteve.

Licencat e hulumtimit për të gjitha mineralet tjera lëshohen në afat prej jo më shumë se 3 vite. Vlen për një sipërfaqe jo më të madhe se 100 km², me mundësi vazhdimi për 3 here ku secili vazhdim nuk mund të jetë më i gjatë se 2 vite, pas çdo vazhdimi sipërfaqja e hulumtimit duhet të reduktohet për 50%.

Asnjë kompani nuk mund të mbajë licenca të shumfishta për hulumtimin e mineraleve ndërtimore që mbulojnë në përgjithësi sipërfaqe më të madhe se 10 km², kurse të të gjitha mineralet tjera nuk mund të mbajë licenca të shumfishta që mbulojnë në përgjithësi sipërfaqe më shumë se 300 km².

Në tabelat e mëposhtme kemi pasqyruar të gjitha licencat e lëshuara nga KPMM gjatë vitit 2012.

Tabela 2: Licencat e lëshuara për hulumtim

Nr.	Nr. i Licencës	NRB	Përshkruesi i Vendit	Lloji i Licencës	Bartës i Apl./Licencës	Data e Lëshimit	Data e Skadimit	Komuna
1.	1014	70383438	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m ³ /d	Hulumtim	"Lika-Trade" Sh.p.k	23.03.2012	22.03.2014	Pejë
2.	1207	70641305	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m ³ /d	Hulumtim	"KO-Procon" Sh.p.k.	28.12.2012	19.12.2014	Mitrovicë

3.	1205	70641356	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m ³ /d	Hulumtim	"Procon" Sh.p.k	07.12.2012	30.11.2014	Mitrovicë
4.	1006	70038754	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m ³ /d	Hulumtim	Company "Bejta Commerce" Sh.a.	15.03.2012	14.03.2014	Shtime
5.	983	70649217	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m ³ /d	Hulumtim	"Vllëzërit Gashi" sh.p.k.	28.05.2012	27.05.2014	Malishevë
6.	1139	70750554	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m ³ /d	Hulumtim	"Alpha" sh.p.k.	19.01.2012	18.01.2014	Kamenicë
7.	1141	70750554	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m ³ /d	Hulumtim	"Alpha" sh.p.k.	25.01.2012	24.01.2014	Vushtrri
8.	1148	70545152	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m ³ /d	Hulumtim	"Sena" Sh.p.k	14.03.2012	13.03.2014	Klinë
9.	1173	70768461	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m ³ /d	Hulumtim	"Veli Comerc" sh.p.k.	14.06.2012	13.06.2014	Ferizaj
10.	1144	70793547	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m ³ /d	Hulumtim	"KODRA" Sh.p.k.	09.03.2012	08.03.2014	Klinë
11.	1146	70790327	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m ³ /d	Hulumtim	"Galeniti"sh.p.k.	13.03.2012	12.03.2014	Kamenicë
12.	1147	70790327	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m ³ /d	Hulumtim	"Galeniti"sh.p.k.	13.03.2012	12.03.2014	Kamenicë
13.	1158	70367720	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m ³ /d	Hulumtim	"GWF"sh.p.k.	25.04.2012	24.04.2014	Gjilan
14.	1168	70243206	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m ³ /d	Hulumtim	N.P.N."Nikollaj" sh.p.k.	25.05.2012	24.05.2014	Gjakovë
15.	1157	70812940	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m ³ /d	Hulumtim	"AASHGK Construction" sh.p.k.	17.04.2012	16.04.2014	Gllgovc
16.	1187	80606044	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m ³ /d	Hulumtim	"Eltoni" sh.p.k.	17.09.2012	16.09.2014	Vushtrri
17.	1190	80337078	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m ³ /d	Hulumtim	"VE-Mor" sh.p.k.	24.10.2012	25.07.2014	Pejë
18.	1180	70821850	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m ³ /d	Hulumtim	"MB- Mineral" sh.p.k.	13.11.2012	03.07.2014	Gjakovë
19.	1176	70817055	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m ³ /d	Hulumtim	"4 Vllëzërit"sh.p.k.	25.06.2012	24.06.2014	Ferizaj
20.	1184	70150191	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m ³ /d	Hulumtim	Korporata Projektuese dhe prodhuese "Pro- ENG"	06.08.2012	24.07.2014	Gjilan

21.	1179	70643677	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Hulumtim	"Rida - Xh. Construction" sh.p.k.	18.07.2012	17.07.2014	Gjilan
22.	1174	70367993	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Hulumtim	"Mermer Commerce Sh.p.k. 1"	18.06.2012	17.06.2014	Shtime
23.	1186	70807149	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Hulumtim	"Melosi Com" sh.p.k.	30.08.2012	21.08.2014	Istog
24.	1199	70817055	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Hulumtim	"4 Vllezërit"sh.p.k.	21.11.2012	07.11.2014	Ferizaj
25.	1162	70779315	K-3 - rërë kuarc core	Hulumtim	"Sand" sh.p.k.	16.05.2012	15.05.2014	Gjakovë
26.	1164	70488418	K-3 - rërë kuarc core	Hulumtim	"Chrom Kosova" SH.P.K.	21.05.2012	20.05.2014	Gjakovë
27.	1183	70101737	K-3 - rërë kuarc core	Hulumtim	Ndërmarrja Prodhuese Tregtare "Bled" sh.p.k.	31.07.2012	13.07.2014	Gjakovë
28.	988	70507188	M-1 - Minerale Metalike	Hulumtim	Karova Energy Investment INC.SH.A	19.01.2012	18.01.2015	Dragash
29.	1136	70507188	M-1 - Minerale Metalike	Hulumtim	Karova Energy Investment INC.SH.A	19.01.2012	18.01.2015	Gjilan
30.	1160	70748746	M-1 - Minerale Metalike	Hulumtim	"Prague Metal" sh.p.k.	15.05.2012	14.05.2015	Kaçanik
31.	1140	70434550	M-1 - Minerale Metalike	Hulumtim	Innomatik Exploration Kosovo L.L.C.	23.01.2012	22.01.2015	Dragash
32.	1201	70544563	M-1 - Minerale Metalike	Hulumtim	"ARSI"sh.p.k. Njësia punuese ne Kosovë	24.12.2012	12.06.2013	Gjakovë
33.	1202	70544563	M-1 - Minerale Metalike	Hulumtim	"ARSI"sh.p.k. Njësia punuese ne Kosovë	24.12.2012	29.03.2015	Prizren
34.	1178	70434550	M-1 - Minerale Metalike	Hulumtim	Innomatik Exploration Kosovo L.L.C.	27.06.2012	26.06.2015	Novobërdë
35.	1154	70798735	M-1 - Minerale Metalike	Hulumtim	"London Mining" sh.p.k.	12.04.2012	11.04.2015	Gllgovc
36.	1155	70798735	M-1 - Minerale Metalike	Hulumtim	"London Mining" sh.p.k.	12.04.2012	11.04.2015	Viti
37.	1156	70798735	M-1 - Minerale Metalike	Hulumtim	"London Mining" sh.p.k.	12.04.2012	11.04.2015	Suharekë
38.	1151	70798182	M-1 - Minerale Metalike	Hulumtim	"Esan Kosova" sh.p.k.	02.04.2012	01.04.2015	Mitrovicë Podujevë
39.	1152	70798182	M-1 - Minerale Metalike	Hulumtim	"Esan Kosova" sh.p.k.	02.04.2012	01.04.2015	Prishtinë
40.	1167	70810298	M-1 - Minerale Metalike	Hulumtim	"Arsi & Arsiminen" sh.p.k.	24.05.2012	23.05.2015	Zubinpotok
41.	1182	70836963	M-1 - Minerale Metalike	Hulumtim	"Sharr Xehe"sh.p.k.	30.07.2012	20.07.2015	Kaçanik

42.	1203	70544563	M-1 - Mineralet Metalike	Hulumtim	"ARSI" Sh.p.k.Dega në Kosovë	24.12.2012	30.10.2014	Gjakovë
43.	1204	70544563	M-1 - Mineralet Metalike	Hulumtim	"ARSI" Sh.p.k.Dega në Kosovë	24.12.2012	30.10.2014	Rahovec
44.	1195	70859645	M-1 - Mineralet Metalike	Hulumtim	"SMIIBAW" sh.p.k.	08.11.2012	22.10.2015	Kamenicë
45.	1015	70350236	M-2 - Matriali industrial	Hulumtim	Miniera dhe Industria e Magnezitit "Golesh"	30.05.2012	09.05.2013	Lipjan

Tabela 3: Numri i licencave për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale

Lloji i lëndës minerare	Nr. i licencave
K-2 - guri i forte	24
K-3 - rrëzë kuarcore	3
M-1 - Minerale Metalike	17
M-2 - Mineral industrial	1
Totali	45

3.1.2. Licencat e shfrytëzimit

Me "Licencë për shfrytëzim" nënkupton licenca e lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në bazë të pjesës V të Ligjit Nr. 03/L-163. Licencat për shfrytëzim për të gjitha mineralet, përveç mineraleve energjetike mund të lëshohen me kohëzgjatje maksimale prej 25 viteve me mundësi vazhdimi deri në 25 vite tjera. Licencat për shfrytëzim për mineralet energjetike kanë kohëzgjatje maksimale 30 vite me mundësi vazhdimi edhe për 15 vite të tjera.

Periudha kohore e një licence të shfrytëzimit caktohet sipas rezervave të shfrytëzueshme (sipas elaboratit të shfrytëzimit) dhe sipas dinamikës së shfrytëzimit.

Në tabelën e mëposhtme kemi pasqyruar të gjitha licencat për shfrytëzim të lëshuara nga KPMM gjatë vitit 2012.

Tabela 4: Licencat e shfrytëzimit të lëshuara në vitin 2012

Nr.	Nr. i Lic.	NRB	Përshkrimi i Vendit	Lloji i Licencës	Bartës i Apl./Licencës	Data e Lëshimit	Data e Skadimit	Komuna
1.	1161	70403199	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Shfrytëzim	Blendi Sh.p.k.	14.06.2012	13.06.2022	Glogovc
2.	1163	80003404	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Shfrytëzim	"Fasada" sh.p.k.	17.05.2012	16.05.2028	Shtime
3.	939	70385718	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Shfrytëzim	"Monimix" Sh.p.k.	12.07.2012	11.07.2017	Prizren

4.	1153	70493616	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Shfrytëzim	"Kosan" L.L.C	03.04.2012	02.04.2023	Gjilan
5.	992	80647123	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Shfrytëzim	"Burimi" Sh.P.K	29.02.2012	28.02.2016	Kaçanik
6.	1145	70036728	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Shfrytëzim	"KAG - Asphalt Company" Sh.p.k.	12.03.2012	11.03.2022	Rahovec
7.	1170	70363247	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Shfrytëzim	N.T.P. "Eurokos" Sh.p.k.	30.05.2012	04.04.2014	Gollogovc
8.	1200	80035896	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Shfrytëzim	N.T.SH. " Gurina " SH.P.K	15.11.2012	05.06.2031	Kaçanik
9.	1150	70037671	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Shfrytëzim	Companya " Eskavatori " Sh.p.k.	28.03.2012	27.03.2021	Lipjan
10.	1143	80011288	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Shfrytëzim	N.T.P. "Pro - Ars"	09.03.2012	08.03.2018	Gjilan
11.	1142	70106671	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Shfrytëzim	"Migjeni" sh.p.k.	02.02.2012	01.02.2020	Gollogovc
12.	1172	80106050	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Shfrytëzim	N.P.SH "Vëllezërit e Bashkuar" Sh.P.K	14.06.2012	13.06.2020	Shtime
13.	1169	70609193	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Shfrytëzim	"Idila" Sh.p.k	25.05.2012	24.05.2023	Pejë
14.	1166	70498324	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Shfrytëzim	"Karakushi" sh.p.k.	22.05.2012	21.05.2027	Gjakovë
15.	1177	70658836	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Shfrytëzim	"Krasniqi" sh.p.k.	04.07.2012	03.07.2020	Suharekë
16.	1175	70384491	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Shfrytëzim	"Vocolli" Sh.p.k.	22.06.2012	21.06.2019	Podujevë
17.	1181	70793547	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Shfrytëzim	"KODRA" Sh.p.k.	25.07.2012	14.07.2019	Lipjan
18.	1191	80143745	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Shfrytëzim	N.P.Q. "Guri i Bekuar"	11.10.2012	01.10.2022	Kaçanik
19.	1192	80143745	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Shfrytëzim	N.P.Q. "Guri i Bekuar"	11.10.2012	01.04.2015	Kaçanik
20.	1198	70435887	K-2 - guri i forte, konstr. Mat., <40 m³/d	Shfrytëzim	"Gerlica-Company" sh.p.k.	15.11.2012	05.05.2016	Ferizaj
21.	973	70370044	K-3 - rërë dhe zhavor	Shfrytëzim	"Union Comerc" sh.p.k.	18.04.2012	15.03.2014	Pejë
22.	1054	80595760	K-3 - rërë dhe zhavor	Shfrytëzim	"Ermali" sh.p.k.	18.04.2012	04.05.2014	Gjakovë

23.	991	70381674	K-3 - rërë dhe zhavor	Shfrytëzim	"Gashi " Sh.p.k.	18.04.2012	13.09.2014	Pejë
24.	1020	70369723	K-3 - rërë dhe zhavor	Shfrytëzim	"Gurthyesi " Sh.p.k.	19.04.2012	18.04.2013	Pejë
25.	1057	70414742	K-3 - rërë dhe zhavor	Shfrytëzim	"Besi Comerc" sh.p.k	27.04.2012	05.05.2013	Kamenicë
26.	1126	70391208	K-3 - rërë dhe zhavor	Shfrytëzim	"Frashër i Madhë" Sh.p.k.	23.04.2012	22.04.2014	Mitrovicë
27.	1051	80171781	K-3 - rërë dhe zhavor	Shfrytëzim	N.T.T."Rama-Trans"sh.p.k.	27.04.2012	22.11.2014	Rahovec
28.	1096	70423360	K-3 - rërë dhe zhavor	Shfrytëzim	"Daci " Sh.p.k.	19.04.2012	04.10.2016	Pejë
29.	1124	80115385	K-3 - rërë dhe zhavor	Shfrytëzim	"V. Kastrati" sh.p.k	23.04.2012	22.04.2015	Pejë
30.	1083	70369981	K-3 - rërë dhe zhavor	Shfrytëzim	"Dakaj - H" Sh.p.k	18.04.2012	20.09.2015	Pejë
31.	1094	70371882	K-3 - rërë dhe zhavor	Shfrytëzim	"Betonjerka" sh.p.k.	18.04.2012	04.10.2015	Pejë
32.	1193	70012952	K-3 - rërë kuarcore	Shfrytëzim	"Xella Kosova"L.L.C	19.12.2012	10.07.2016	Lipjan
33.	1185	70420251	K-3 - rërë dhe zhavor	Shfrytëzim	Company "Tini" sh.p.k.	28.08.2012	04.08.2020	Gjakovë
34.	1196	70101737	K-3 - rërë kuarcore	Shfrytëzim	Ndërmarrja Prodhuese Tregtare "Bled" sh.p.k.	07.11.2012	31.10.2021	Gjakovë
35.	432	70713179	K-3 - rërë dhe zhavor	Shfrytëzim	"BESNIKU - Q " sh.p.k.	18.04.2012	10.10.2012	Pejë
36.	548	70366470	K-3 - rërë dhe zhavor	Shfrytëzim	"Gipa" Sh.p.k.	19.04.2012	07.09.2012	Rahovec
37.	538	70360176	K-3 - rërë dhe zhavor	Shfrytëzim	"Luani Transport " Sh.p.k.	27.04.2012	27.07.2014	Pejë
38.	1197	70748746	M-1 - Mineralet Metalike	Shfrytëzim	"Prague Metal" sh.p.k.	20.11.2012	06.05.2015	Kaçanik
39.	1149	70484189	M-2 - Matriali industrial	Shfrytëzim	"Boksh Kosova " SH.P.K.	22.03.2012	20.02.2022	Gjakovë
40.	1189	70429684	M-2 - Matriali industrial	Shfrytëzim	"Apollonia" Sh.p.k	25.10.2012	13.09.2021	Gjakovë

Tabela 5: Numri i licencave për shfrytëzim sipas llojeve të lëndëve minerale

K-3 - rërë dhe zhavor	15
K-3 – rërë kuarcore	2
K-2 - guri i forte	20
M-1 - Minerale Metalike	1
M-2 - Mineral industrial	2
Totali	40

3.1.3. Lejet për Aktivitetet e Veçanta

Lëshohen sipas pjesës së VI të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet. Kohëzgjatja dhe fushëveprimi i çdo Leje përcaktohet nga KPMM-ja, në mënyrë të arsyeshme dhe të

drejtpërdrejt dhe racionale në lidhje me ushtrimin e aktiviteteve të veçanta të autorizuar me Lejen në fjalë.

Në grupin e Lejeve për Aktivitetet e Veçanta përfshihen:

(a) Leje për fillim të punëve (licenca e hulumtimit):

- Shpimet,
- Hapja e kanaleve,
- Marrja e mostrave, duke përfshirë edhe mostrat e papërpunuara,
- Vrojtimit gjeofizike, ku përfshihen matjet me anë të aeroplanëve ose metodave elektrike me tension të lartë,
- Funksionimi i makinerisë ose pajimeve dhe
- Çdo veprimtari e ndërlidhur e kryer për qëllime të kërkimit të cilat e ndryshojnë apo e çrregullojnë fizikisht sipërfaqen e tokës.

(b) Leje për përdorimin e lëndëve plasëse për nevojat e sektorit mineral,

(c) Leje për punë në xehetari:

- Përdorimi ose funksionimi i makinerisë apo i pajimeve ose
- Veprimtaritë tjera që mund të caktohen nga KPMM

(d) Leje për përpunimin e lëndëve të para minerale:

- Përdorimi ose funksionimi i makinerisë apo pajimeve,
- Përdorimi i kemikateve ose reagjentëve të tjerë, ose
- Veprimtaritë tjera që mund të caktohen nga KPMM

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar detajet e lejeve për aktivitetet e veçanta të lëshuara nga KPMM për vitin 2012.

Tabela 6: Lista e lejeve per aktivitete të veçanta te lëshuara gjate vitit 2012

Nr:	Nr. i Lejes	NRB	Kompania Aktuale Operuese	Lloi i Makinerive	Statusi i Tanishëm	Data e Lëshimit	Data e Skadimit	Komuna
1.	282	70075371	N.P.N. "Renelual Tahiri" Sh.p.k.	baza e asfaltit	Licencë e Lëshuar	01.02.2012	31.01.2015	Prizren
2.	283	70729636	"Shaq Company" sh.p.k.	baza e betonit	Licencë e Lëshuar	01.02.2012	31.01.2015	Ferizaj
3.	285	70150191	Korporata Projektuese dhe prodhuese "Pro-ENG"	baza e betonit	Licencë e Lëshuar	28.03.2012	27.03.2015	Gjilan
4.	194	70391208	"Frashër i Madhë" Sh.p.k.	sortues	Licencë e Lëshuar	23.04.2012	22.04.2015	Mitrovicë
5.	230	70350236	Miniera dhe Industria e Magnezitit "Golesh"	sortues	Licencë e Lëshuar	30.05.2012	08.11.2014	Lipjan
6.	279	70713179	"BESNIKU - Q " sh.p.k.	sortues	Licencë e Lëshuar	27.06.2012	26.06.2015	Pejë
7.	281	70435887	"Gerlica-Company" sh.p.k.	sortues	Licencë e Lëshuar	06.04.2012	05.04.2015	Ferizaj
8.	294	70369723	"Gurthyesi " Sh.p.k.	sortues	Licencë e Lëshuar	08.10.2012	10.08.2015	Pejë
9.	284	70303038	N.P.SH. "Buardi" sh.p.k.	sortues	Licencë e Lëshuar	23.03.2012	22.03.2015	Ferizaj
10.	286	70431016	"Zhavor Company " Sh.p.k.	sortues	Licencë e Lëshuar	25.04.2012	24.04.2015	Viti

11.	291	80003404	"Fasada" sh.p.k.	sortues	Licencë e Lëshuar	20.06.2012	19.06.2015	Shtime
12.	290	80676077	"Dakaj - M" SH.P.K	sortues	Licencë e Lëshuar	14.06.2012	13.06.2015	Pejë
13.	292	70385373	Mineral L.L.C	sortues	Licencë e Lëshuar	29.08.2012	10.08.2015	Gllgovc

Më poshtë kemi paraqitur në mënyrë tabelore dhe grafike numrin e të gjitha licencave të lëshuara në vitin 2012 për Leje për aktivitete të veçanta si dhe kemi bere krahasimin në formë grafike.

Tabela 7: Lista e lejeve të lëshuara per vitin 2012 për leje për aktivitete të veçanta

Sortues	10
Baza e betonit	2
Baza e asfaltit	1
Total	13




Figura 3. Grafiku i lejeve të lëshuara gjate vitit 2012

4. PROJEKTET E KPMM 2012

Nga projektet zhvillimore për vitin 2012, nga KPMM janë realizuar këto programe:

- Përpilimi i dy plansheteve të hartës gjeologjike të Kosovës 1:25000,
- Mbështetje KPMM-se për kryerjen e Analizave Gjeokimike 2010-2012

4.1. Përpilimi i Plansheteve të hartës Gjeologjike të Kosovës

Përpilim i dy plansheteve të hartës gjeologjike më shkallën 1 : 25 000 për rajonin e Drenasit Plansheti Blinajë **K34-54 Bd**, dhe Plansheti **Drenas K34-54 Bb**. Ky projekt kërkim – vlerësimi parësor në themel të tij ka hartografimin e rajonit të marrë në studim, me të gjithë komponentët e nevojshëm. Rezultatet e këtij studimi do të ngrenë në një nivel më të lartë njohuritë gjeologjike për këtë rajon, kapacitetet prodhuese, zhvillimin e integruar të popullsisë dhe rritjen e nivelit ekonomik të sajë.

Hartografimet gjeologjike në shkallë 1 : 25 000 do të jenë një bazë e shëndoshë për menaxhimin më të mirë të territoreve. Ato do të jenë baza për hartat gjeomjedisore, hidrogjeologjike, gjeologo – inxhinierike, agrogjeologjike etj.




Figura 4. Harta gjeologjike e Planshetit të Drenasit në shkallë 1:25 000




Figura 5. Harta gjeologjike e Planshetit të Blinajës në shkallë 1:25 000

4.1. Mbështetje KPMM-se për kryerjen e Analizave Gjeokimike 2010-2012

Gjatë vitit 2010 – 2012 është kryer projekti i gjeokimisë së sedimenteve në rrjedhat e përroskave dhe lumenjve në tërë territorin e Kosovës e financuar kjo Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian në vlerë prej rreth 1 milion euro. Të gjitha procedurat e prokurimit janë ushtruar nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian, ndërsa implementimi i këtij projekti ka filluar në shkurt të vitit 2010 dhe ka zgjat deri në shkurt 2012.

Gjatë vitit 2010 - 2011 kompania implementuese e projektit në fjalë (**Consortium abc-associated business consultants gmbh & Brenk Systemplanung GmbH**), ka realizuar marrjen e 3406 mostra. Numri i përgjithshëm i mostrave për tërë territorin e Kosovës duke përfshi këtu dhe mostrat që janë marr gjatë viteve 2006-2007 është 4000 mostra.

Të dhënat e siguruar shërbejnë si një bazë për aktivitetet e hulumtimeve gjeologjike të mëtejme në sektorin e resurseve minerale.

Projekti si tërësi ishte i ndarë në pesë faza, gjatë të cilave ekzekutuar 17 detyra.

KPMM ka kontribuar në realizimin e këtij qoftë në infrastrukturë ashtu dhe me staf profesional në funksion të provëmarjes, si dhe ka ofruar staf dhe zyre për përpunim dhe interpretim të dhënave.

Të gjitha të dhënat janë të përpunuara dhe të përshkruara në formë të raporteve dhe po ashtu të paraqitura në harta, të dhëna statistikore dhe paraqitje në formë të grafikonëve të ndryshëm. Po ashtu të gjitha të dhënat janë vendosur në Gjeodatabazen e Kosovës në KPMM.

Finalizimi i projektit është bërë në Shkurt 2012 ku stafi i Departamentit të Gjeologjisë të KPMM-së ka dhënë kontribut në: përgatitjen e hartave dhe vendosja e pikave për marrje të mostrave, përgatitja e të gjitha hartave që kjo kompani ka bërë në prezantimin e tyre gjatë konferencës së donatorëve organizuar nga KPMM dhe ABC.




Figura 6. Shpërndarja e mineralizimeve të arit në territorin e Kosovës.

Plani i menaxhimit të resurseve minerale

Më qëllim të vendosjes së objektivave të shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore të Kosovës, duke pas parasysh specifikat dhe kushtet e veçanta të një zone të caktuar, paraqitet e veçanta të resurseve minerale si dhe nevojat për hulumtimin dhe përdorimin e tyre. Për arritjen e objektivave të më sipërme Plani i Menagjimit të resurseve ishte paraparë të realizohej në periudha të ndryshme kohore. Faza e par e këtij projekti u realizua gjatë vitit 2009 dhe faza dytë gjatë vitit 2010. Vazhdimi i realizimit të projektit në vitet vijuese nuk u bë pasi që në Ligjin e Minerave dhe Mineraleve Nr.03/L-163 bazuar kjo në nenin 73 Ministria e Energjisë dhe Minerave së bashku me Institutin Gjeologjik do të duhej të përgatiste Strategjinë Minerare gjë që u realizua gjatë vitit 2012.

5. AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË INSPEKTORATIT

Inspektorati i Minierave është Departament në kuadër të KPMM-së dhe ushtron funksionet e besuara në pajtim me ligjin nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet.

Me Inspektoratin e Minierave udhëheqë Kryeinspektori i cili emërohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Sipas ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, Kryeinspektori përgatit dhe dorëzon Ministrit të MZHE-së, KPMM-se, Kuvendit dhe Qeverise një raport te hollësishëm vjetor lidhur me veprimtarinë, masat dhe vendimet e ndërmarra nga Inspektorati i Minierave.

Konform asaj qe u cek me lart raportin e Kryeinspektorit e keni te bashkangjitur si shtojcë në këtë raport.

6. AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË GJEOLGJISË

Departamenti **Gjeologjisë** në kuadër të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale është i përkushtuar të sigurojë hulumtimin dhe shfrytëzimin e licencuar, të rregullt dhe optimal të resurseve minerale të Kosovës në përputhshmëri me ligjin e Minierave dhe Mineraleve dhe Strategjinë Minerare, shfrytëzim optimal të mineraleve dhe zhvillim të pranueshëm mjedisor:

Gjatë vitit 2012 ka pas një numër të konsiderueshëm të interesuarve për tu marr më aktivitete minerare, si dhe aplikacione si për hulumtime të vendburimeve metalore ashtu dhe ato jo metalore. Duke pas parasysh këtë dhe projektet e tjera që kanë qenë në realizim në kuadër të KPMM-së departamenti gjeologjisë gjatë këtij viti ka kryer një serë aktivitete në përputhshmëri me detyrat e parapara si dhe aktivitete të tjera të ndërlidhura në mes të departamenteve.

Realizimi i detyrave të përgjithshme të departamentit

- Departamenti i gjeologjisë në vazhdimësi ka bërë vlerësim adekuat për aplikacionet e kompanive të ndryshme për hulumtim apo shfrytëzim qofshin ato metalore apo jo metalore.
- Sipas kërkesave të institucioneve dhe të interesuarve të tjerë përgatit informacione gjeologjike, kemi ofruar këshilla nga më të ndryshmet sipas kërkesave.
- Departamenti i gjeologjisë i përmbahet në tërësi udhëzimit administrativ 07/2007 mbi “Rregullat dhe procedurat për pranimin dhe përpunimin e kërkesave për licenca dhe leje” neni 6.
- Më qëllim të avancimit të gjeo-databazës Departamenti i gjeologjisë në kohë ka qenë pjesë aktive dhe kyçe në përgatitjen e termave të referencës më qëllim që nga gjeo-databaza në kohë optimale të mund të nxjerrën çfarëdo informacioni qoftë gjeologjik apo dhe të tjera për aktivitet e kompanive.
- Në mungesë të një moduli adekuat në Gjeo-databazë për resurset/rezervat e shfrytëzuara, departamenti i gjeologjisë ka përpiluar një data-bazë në EXCEL për mbajtjen e shënimeve për rezervat e shfrytëzuara nga kompanitë. Meqenëse kjo data-bazë e krijuar me herët nga departamenti i gjeologjisë ishte përpiluar që të jetë funksionale deri me 2015, duke qenë se është nevojë e kohës që dada-bazat të avancohen kemi bërë përmirësime dhe avancime të nevojshme në mënyrë që në kohë shumë efektive brenda minutave të nxjerrën informacione nga më të ndryshme qoftë të veçanta për kompani, për lëndë të veçanta minerale, për regjione të veçanta etj. tani kjo data-bazë e resurseve është e programuar dhe e përshtatur që të jetë funksionale deri më 2030.
- Arkivi është kujdesuar dhe ka arrit që në kohë të bëjë skanimin dhe arkivimin e çdo dokumentacioni, njoftimin me P-Elektronike tek drejtori, kryesueseve të departamenteve apo dhe tek stafi tjetër për të cilin ka të bëjë dokumenti të gjitha këto bazuar në udhëzimin administrativ 07/2007 neni 3.
- Arkivi ju ka përmbajt në përpikëni orarit të përgatitjes së ndonjë dokumentacioni sipas kërkesave të palëve të treta për shfrytëzimin të materialit arkivor sipas udhëzimit administrativ 004/2012 “ Rregullat dhe tarifat e shërbimeve për palët e treta të kryera nga arkiva e KPMM-së”, arkivi mban regjistër të rregullt për dokumentet e dhëna tek pala. Ka

skanuar protokolluar në kohë optimale (përpos në rate të veçanta) të gjitha dokumentet hyrëse dhe dalëse.

- Laboratori është pjese përbërëse e Departamentit të Gjeologjisë themelimi i të cilit është bërë që të shërbejë Institutit Gjeologjik, kjo nënkupton që me momentin e funksionalizimit të Institutit Gjeologjik të bëhet pjesë e tij. Për këtë çështje kemi bërë takime zyrtare ndër-institucionale me MZHE, dhe është arritur marrëveshja.

Gjatë vitit 2012 në KPMM nga numri i përgjithshëm prej 133 aplikacioneve, sipas lendeve minerale janë të paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 8: Aplikacionet e kompanive për aktivitete minerare për 2012

Aplikacionet për hulumtim gjat vitit 2012		
Andezite	Hulumtim	1
Bazalte	Hulumtim	3
Bazalte	Hulumtim - Vazhdim licence	1
Diabaze	Hulumtim	1
Gëlqeror	Hulumtim	24
Gëlqeror	Hulumtim - Vazhdim licence	3
Gëlqeror	Hulumtim - Transfer licence	2
Industriale	Hulumtim	1
Magnezite	Hulumtim	1
Mergelë	Hulumtim	2
Mergelë	Hulumtim - Vazhdim licence	2
Mermer	Hulumtim	1
Metalore	Hulumtim	21
Metalore	Hulumtim - Vazhdim licence	4
Rëra dhe zhavorre	Hulumtim	9
Rëra kuarcore	Hulumtim	3
Rreshpe kuarcore	Hulumtim	1
Shkëmbinj të fortë	Hulumtim	10
Serpentine	Hulumtim	1
Gjithësej		91
Aplikacionet për Shfrytëzim gjat vitit 2012		
Argjilë	Shfrytëzim	1
Argjilë	Shfrytëzim - Transfer licence	1
Bazalte	Shfrytëzim	1

Andezite	Shfrytëzim - Transfer licence	1
Dunite	Shfrytëzim	1
Gëlqeror	Shfrytëzim	13
Gëlqeror	Shfrytëzim - Transfer licence	1
Gëlqeror	Shfrytëzim - Bashkim licence	6
Gëlqeror	Shfrytëzim - Zgjerim licence	1
Mergelë	Shfrytëzim	1
Metalore	Shfrytëzim	1
Metalore	Shfrytëzim - vazhdim licence	2
Rëra dhe zhavorre	Shfrytëzim	2
Rëra dhe zhavorre	Shfrytëzim - vazhdim licence	2
Rëra kuarcore	Shfrytëzim	5
Rëra kuarcore	Shfrytëzim - vazhdim licence	1
Tallk	Shfrytëzim	1
Magnezite	Shfrytëzim - vazhdim licence	1
Gjithësej		42

Nga stafi i departamentit te Gjeologjisë janë kryer shqyrtimet e aplikacioneve sipas detyrave dhe pergjegesise dhe jane proceduar me kohe per shqyrtim te metutjeshem.

Prezantim statistikor i rezervave të shfrytëzuara gjatë vitit 2012 sipas lëndëve minerale. Vendburimit jo metalore

Nga ana e kompanive të licencuar për shfrytëzimin të gjitha llojeve të mineraleve sipas periudhave kohore janë pranuar arkivuar dhe sistemuar **543 raporte**.

Statistika e raportimeve të kompanive për vitin 2012 është e paraqitur në tabelën me më poshtme, duke paraqitur kështu në formë numerike numrin e raportimeve

Tabela 9: Statistika e raportimeve të kompanive për vitin 2012

Statistike e raporteve të Kompanive		
Viti	Periudha	Të gjitha regjionet
2012	Janar-Mars	134
	Prill-Qershor	142
	Korrik-Shtator	140
	Tetor-Dhjetor	127

Të dhënat mbi planifikimin (sipas kompanive) dhe rezervat e shfrytëzuara vetëm gjatë vitit 2012 për lëndët minerale ndërtimore janë të paraqitura në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

Tabela 10: Rezervat e shfrytëzuara për material ndërtimor ne vitin 2012

Nr.	Lënda minerale	Sasia e lëndës minerale					Njësia matëse
		Planifiki m	Realizi m - Minim	Realizim - Raportim	Planifikim -Minim në %,	Planifikim- Raportim në %,	
1	Andezit	263,440	28,673	23,555	11%	9%	m ³
2	Argjilë	277,070	0	50,757	0	18%	m ³
3	Gëlqeror	5,042,365	2,577,280	2,482,076	51%	49%	m ³
4	Bazalt	118,900	8,743	0	7%	0%	m ³
5	Rërë dhe Zhavorr	139,200	0	22,186	0	16%	m ³
6	Rërë kuarcore	44,500	0	23,740	0	53%	m ³
7	Dunite	115,000	95,304	26,219	83%	23%	m ³
8	Mergelë	561,961	0	128,161	0	23%	m ³




Figura 7. Rezervat e shfrytëzuara të lëndëve minerale ndërtimore

Momentalisht KPMM i ka të lëshuara dy licenca për shfrytëzim të linjitit dhe atë Bardh- Mirash dhe Sibovc rezervat e shfrytëzuara së bashku janë të prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Tabela 11: Paraqitje tabelare e rezervave të shfrytëzuara të linjitit gjatë vitit 2012

Rezervat e shfrytëzuara -nga KEK 2012						
1	Lënda minerale	Planifikimi	Realizimi	Ndryshimi	Realizimi në %	Njësia
2	Lignit	8,000,000	8,028,397.00	-28,397	100.35%	ton

Në grafikun e më poshtëm është paraqitur planifikimi dhe realizimi i prodhimit të lignitit sipërfaqësor në kuadër të licencave të KEK nga 2005 deri më 2012.

Rezervat e shfrytëzuara - nga KEK 2005 - 2012




Figura 8. Raporti në mes të planifikimit dhe shfrytëzimit të linjiteve për vitet 2005-2012

Në grafikun e më poshtëm është paraqitur raporti në mes të realizimit dhe planifikimit të shfrytëzimit të linjitit.



Figura 9. Realizimi në % i prodhimit të linjitit për vite

Vendburimet metalore - Rezervat e shfrytëzuara për 2012

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura rezervat e shfrytëzuara të xehes së Ni – Co për 2012

Tabela 12: Rezervat e shfrytëzuara të Fe-Ni sipas kompanive për 2012

Sasia e xehes së shfrytëzuar të Fe-Ni, gjatë - 2012						
Nr.	Emri i kompanisë	Emri i Vend shfrytëzimit	Komuna	Planifikimi	Realizimi (t)	Realizimi në %
1	Newco Ferronikeli Complex	Qikatovë	Drenas	0.00	0.00	
		Gllavicë	Lipjani	640,262.80	379,151.21	59.22

	L.L.C.					
2	Guri Company Sh.p.k	Reçak	Lipjani	30,000.00	0.00	0.00
2	Prague Metal sh.p.k.	Ivajë	Kaçanik	0.00	0.00	
		Gjithsejtë		670,262.80	379,151.21	56.57

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm janë të paraqitura rezervat e shfrytëzuara të xehes së Ni – Co për 2006 – 2012

Tabela 13: Rezervat e shfrytëzuara të Fe-Ni sipas viteve

Viti	Planifikimi	Realizimi	Nyje e xehes	Realizimi në %	Njësia
2006	0.00	279,804.50	0.00		ton
2007	0.00	170,056.01	145,882.29		ton
2008	1,181,000.00	677,426.20	738,477.82	57.36	ton
2009	700,451.60	918,709.00	1,012,544.29	131.16	ton
2010	890,000.00	779,505.69	942,945.79	87.58	ton
2011	720,000.00	683,854.87	606,221.43	94.98	ton
2012	670,262.80	379,151.21	446,658.54	56.57	ton
2006-2012	4,161,714.40	3,888,507.48	3,892,730.16	93.44	ton

Prodhimi i xehes së Ni 2006 - 2012




Figura 10. Paraqitje grafike e rezervave të shfrytëzuar të Fe-Ni sipas viteve

Gjatë vitit 2012 në kanë qenë të licencuara 4 miniera që shfrytëzojnë lëndë minerale metalore të Pb-Zn, planifikimi dhe realizimi i prodhimit është paraqitur në tabelën e më poshtme.

Tabela 14: Rezervat e shfrytëzuara të xehes së Pb-Zn për 2012


Sasia e xehes së shfrytëzuar të Pb-Zn, gjatë - 2012				
Nr.	Emri i kompanisë	Planifikimi në (t)	Realizimi në %	Realizimi në %
1	Stanterg	160,830.00	125,942.00	78.31
2	Artanë	48,750.00	39,418.06	80.86
3	Cernac	Ska raportime	50,931.00	
4	Beloberdë	Ska raportime	9,198.80	
Githësej		209,580.00	165,360.06	78.90

Në tabelën dhe grafikun e më poshtëm kemi paraqitur realizimin e prodhimitarisë për mineralet metalore të Pb-Zn sipas viteve.

Tabela 15: Rezervat e shfrytëzuara nga minierat e Trepçës nga 2005-2012

Sasia e xehes së shfrytëzuar të Pb-Zn, gjatë - 2005-2012 të gjitha minierat			
Viti	Planifikimi në (t)	Realizimi në (t)	Realizimi në %
2005	0.00	26,144.90	
2006	0.00	88,601.00	
2007	0.00	108,868.20	
2008	233,464.00	141,769.20	60.72
2009	302,545.00	158,137.20	52.27
2010	204,420.00	185,841.57	90.91
2011	155,680.00	194,771.66	125.11
2012	209,580.00	165,360.06	78.90
2005-2012	1,105,689.00	1,069,493.79	96.73


Koment: Për minierat e Belobërdës dhe të Cernacit nuk ka planifikim për 2012

Sasia e xehes së shfrytëzuar të Pb-Zn, gjatë - 2005-2012 të gjitha minierat**Figura 11. Sasia e prodhuar e Pb-Zn sipas viteve**

Në tabelën dhe grafikun e më poshtëm janë të paraqitura të gjitha rezervat e shfrytëzuara sipas minierave të Trepçës nga viti 2005-2012

Tabela 16: Prodhimi i Pb-Zn sipas minierave nëpër vite

Sasia e xehes së shfrytëzuar të Pb-Zn, gjatë - 2005-2012 sipas minierave					
Viti	Stanterg	Artanë	Cernac	Beloberd	Njësia
2005	12,200.00	7,357.90	4,965.00	1,622.00	ton
2006	42,876.00	15,701.00	27,801.00	2,223.00	ton
2007	55,901.00	6,613.00	43,319.00	3,035.20	ton
2008	69,854.00	20,964.20	44,503.00	6,448.00	ton
2009	89,225.00	30,530.20	34,747.00	3,635.00	ton
2010	96,120.00	30,755.57	47,072.00	11,894.00	ton
2011	83,102.00	38,190.66	63,163.00	10,316.00	ton
2012	125,942.00	39,418.06	50,931.00	9,198.80	ton
2005-2011	575,220.00	189,530.59	316,501.00	48,372.00	ton

Sasia e xehes së shfrytëzuar të Pb-Zn, gjatë - 2005-2012 sipas minierave**Figura 12. Prodhimi i Pb-Zn sipas kompanive dhe viteve**

Në tabelën dhe grafikun e më poshtëm janë të paraqitura rezervat e shfrytëzuara e mineralit të kromit -2012,

Për shfrytëzim te mineralit të Cr_2O_3 kemi të licencuar vetëm 1(një) Kompani.

Tabela 17: Prodhimi i Cr_2O_3

Sasia e xehes së shfrytëzuar të Cr_2O_3 , gjatë vitit 2012				
Viti	Emri i Kompanisë	Planifikimi në (t)	Realizimi në (t)	Realizimi në %
2012	"ARSI" Sh.p.k.Dega në Kosovë	10,000.00	2,000.00	20.00%




Figura 13. Prodhimi i xehes së kromit (Cr2O3) për vitin 2012

7. FINANCAT

FINANCAT

Buxheti i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2012 ka qene i ndarë në këto 5 (pesë) linja buxhetore si me poshtë.

Tabela 18: Aprovimi i buxhetit në fillim të vitit 2012

Nr. Ren.	Përshkrimi	Viti 2012
1	Paga dhe Mëditje	615,801.00 €
2	Mallra dhe Shërbime	473,763.00 €
3	Komunali	36,000.00 €
4	Subvencione dhe Transfere	20,000.00 €
5	Projekte Kapitale	550,000.00 €
	Totali i Aprovuar	1,695,564.00 €




Figura 14. Aprovimi i buxhetit në fillim të vitit 2012

Duke e pasur parasysh ndryshimet që kanë qenë pas ndarjes së buxhetit fillestar, në tabelën e më poshtme është prezantuar buxheti final për vitin 2012.

Tabela 19: Aprovimi i buxhetit përfundimtar në vitin 2012

Nr. Ren.	Përshkrimi	Viti 2012
1	Paga dhe Mëditje	615,801.00 €
2	Mallra dhe Shërbime	473,763.00 €
3	Komunali	36,000.00 €
4	Subvencione	- €
5	Projekte Kapitale	380,000.00 €
	Totali i Aprovuar	1,505,564.00 €




Figura 15. Aprovimi i buxhetit në fillim në vitin 2012

Ky ndryshim ka ndodh sipas shkresës së Ministrisë së Financave të dt. 18.05.2012 me numër protokolli të MF 1139, të pranuar në KPMM me dt. 21.05.2012 me numër protokolli të KPMM-ës 2485.

Tema e kësaj shkrese ka qenë: Dorëzimi i Instruksionit për Rishikim të Buxhetit për vitin 2012, pas pranimit të këtij instruksioni, KPMM-ja e ka rishikuar buxhetin dhe me dt 28.05.2012, ju ka përgjigjur kësaj shkrese të Ministrisë së Financave dhe ka kursyer në dy kategori dhe atë në Subvencione dhe Transfere si dhe Projekte Kapitale.

Në Subvencione dhe Transfere janë kursyer 20,000.00 €

Ndërsa në projekte Kapitale janë kursyer 170,000.00 €

Total Kursimi ka qenë 190,000.00 €

Tabela 20: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar në vitin 2012

Nr. Ren.	Përshkrimi	Aprovuar	Shpenzuar	Ndryshimi	Ne %
1	Paga dhe Mëditje	615,801.00 €	606,181.23 €	9,619.77 €	98.44
2	Mallra dhe Shërbime	473,763.00 €	390,593.63 €	83,169.37 €	82.44
3	Komunal	36,000.00 €	34,816.46 €	1,183.54 €	96.71
4	Subvencione	- €	- €	- €	-
5	Projekte Kapitale	380,000.00 €	230,793.16 €	149,206.84 €	60.74
	Totali i Aprovuar	1,505,564.00 €			
	Totali i Shpenzuar		1,262,384.48 €		
	Mbetja			243,179.52 €	
	Totali në %				83.85




Figura 16. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar në vitin 2012

Ne tabelën e me poshtme janë prezantuar Shpenzimet për paga dhe mëditje, Pagat neto, tatimi, dhe pensionet e punëtorit dhe punëdhënësit.

Tabela 21: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për paga në vitin 2012

Nr. Ren.	Pershkrimi	Aprovuar	Shpenzuar	Diferenca	Ne %
1	Pagat Neto	515,221.00	512,025.77	3,195.23	99.4
2	Tatimi ne Paga	39,000.00	36,423.92	2,576.08	93.4
3	Kontributi i Puntorit	30,790.00	28,865.77	1,924.23	93.8
4	Kontributi i Pudhensit	30,790.00	28,865.77	1,924.23	93.8
	Total	615,801.00	606,181.23	9,619.77	98.4




Figura 17. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për paga në vitin 2012

Ne tabelën e me poshtme është prezantuar tabela e shpenzimeve për kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, ne këtë tabelë është bere shpalosja ne bazë te kodeve ekonomike, për me tepër ju lutem shih tabelën e me poshtme


Tabela 22: Buxheti i planifikuar dhe i shpenzuar për mallra dhe shërbime në vitin 2012

Nr. Rën.	Përshkrimi i Lendeve	Kodi ekonomik	Te Planifikuara	Te Shpenzuara	Diferenca	Perqindja shpenzuar
	Totali shpenzimeve te udhetimit dhe avanseve		60,000.00 €	54,441.47 €	5,558.53 €	
1	Shpenzimet e udhetimit jasht vendit	13140	21,000.00 €	18,553.92	2,446.08	88.4
2	Meditjet jasht vendit	13141	2,000.00 €	1,812.80	187.20	90.6
3	Akomodimi	13142	16,000.00 €	14,401.46	1,598.54	90.0
4	Shpenzimet tjera jasht vendit	13143	21,000.00 €	19,673.29	1,326.71	93.7
	Totali i shërbimeve te Telekomunikacionit		26,230.00 €	23,617.35 €	2,612.65 €	
5	Shpenzimet e Internetit per KPMM-ne	13310	1,500.00 €	1,578.10	- 78.10 €	105.2
6	Shpenzimet tjera telefonike - Vala	13320	21,000.00 €	20,550.00	450.00 €	97.9
7	Sherbimet postare	13330	3,300.00 €	1,129.25	2,170.75 €	34.2
8	Shpenzimet per Kablovik	13340	430.00 €	360.00	70.00 €	83.7
	Totali i shpenzimeve dhe shërbimeve te ndryshme		65,997.50	47,838.26	18,159.24	
9	Sherbimet e Arsimit dhe trajnimit	13410	17,000.00 €	16,489.25	510.75 €	97.0
10	Sherbimet e ndryshme intelektuale-kshillëdhense	13440	1,500.00 €	185.60	1,314.40 €	12.4
11	Sherbimet e shtypjes - Jo Marketingut (bilokat)	13450	1,500.00 €	225.00	1,275.00 €	15.0
12	Sherbimet Kontraktuese tjera	13460	44,497.50 €	29,880.67	14,616.83 €	67.2
13	Sherbimet Teknike	13470	500.00 €	145.55	354.45 €	29.1
14	Shpenzimet per Antarësim	13480	1,000.00 €	912.19	87.81 €	91.2
	Totali i mobiljeve dhe paisjeve me pak se 1000 €		40,500.00 €	32,070.33 €	8,429.67 €	
15	Mobilje me pak se 1000 - Inventar	13501	1,000.00 €	-	1,000.00 €	0.0
	Telefona (me pak se 100euro)	13502	4,000.00 €	3,660.00	340.00 €	91.5
	Komputera (me pak se 1000 euro)	13503	3,000.00 €	2,618.00	382.00 €	87.3
16	Furnizim me paisje tjera me pak se 1000 euro	13509	32,500.00 €	25,792.33	6,707.67 €	79.4
	Totali i furnizimeve tjera		38,900.00 €	34,885.62 €	4,014.38 €	
17	Furnizimi i Zyres (Material shpenzues)	13610	15,000.00 €	14,931.12	68.88 €	99.5
18	Furnizimi me Ushqim dhe pije -jo dreka zyrtare	13620	3,900.00 €	-	3,900.00 €	0.0
19	Robrat per Stafin e Terenit	13650	20,000.00 €	19,954.50	45.50 €	99.8
	Totali i derivatit dhe lëndëve djegëse		65,200.00 €	59,692.77 €	5,507.23 €	
20	Vaj per Nxemje	13720	9,000.00 €	8,647.53	352.47 €	96.1
21	Derivate per Gjenerator	13770	1,200.00 €	563.07	636.93 €	46.9
22	Karburante per vetura	13780	55,000.00 €	50,482.17	4,517.83 €	91.8
	Totali i shërbimeve te regjistrimit dhe sigurimit te auto.		27,900.00	25,689.41	2,210.59	
23	Regjistrimi automjeteve	13950	2,900.00 €	2,280.00	620.00 €	78.6
24	Sigurimi i Autometeve	13951	10,000.00 €	9,580.21	419.79 €	95.8
25	Taksa komunale per regjistrim te automjeteve	13952	500.00 €	250.00	250.00 €	50.0
26	Sigurimi i ndertesese te KPMM-se	13953	14,500.00 €	13,579.20	920.80 €	93.6
	Totali i mirëmbajtjeve		63,035.50	59,556.30	3,479.20	
27	Mirëmbajtja e veturave te KPMM-se	14010	44,535.50 €	41,953.27	2,582.23 €	94.2
28	Mirëmbajtja e ndertesese - pastrimi	14020	9,000.00 €	8,366.04	633.96 €	93.0
29	Mirëmbajtja e teknologjis informative	14040	4,000.00 €	3,935.60	64.40 €	98.4
30	Mirëmbajtja e paisjeve dhe mobileve	14050	5,500.00 €	5,301.39	198.61 €	96.4
	Totali i shpenzimeve te qiras		60,350.00	48,730.00	11,620.00	
31	Shpenzimet e qiras dhe te tatimit	14110	60,000.00 €	48,730.00	11,270.00 €	81.2
32	Rezervimi i salles per prezantim	14150	350.00 €	-	350.00 €	0.0
	Totali i shpenzimeve te marketingut		22,000.00	2,503.62	19,496.38	
33	Botimet dhe publikimet	14210	13,000.00 €	1,288.52	11,711.48 €	9.9
34	Shpenzimet per informim publik te KPMM-se	14230	9,000.00 €	1,215.10	7,784.90 €	13.5
	Totali i shpenzimeve te perfaqesimit		3,500.00	1,543.50	1,956.50	
35	Dreka Zyrtare	14310	3,500.00 €	1,543.50	1,956.50 €	44.1
	Totali i shpenzimeve te vendimeve gjyqsore		150.00	25.00	125.00	
36	Shpenzimet per gjykata	14410	150.00 €	25.00	125.00 €	16.7
	Totali		473,763.00 €	390,593.63 €	83,169.37 €	82.44

Ne tabelën e me poshtme është paraqitur buxheti i aprovuar, shpenzuar, diferenca dhe është prezantuar në %, për kategorinë ekonomike Komunali.

Tabela 23: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për komunalitet në vitin 2012

Nr. Ren.	Pershkrimi	Te planifikuara	Te Shpenzuara	Diferenca	Ne %
1	Rryma	19,000.00 €	18,646.30 €	353.70 €	98.14
2	Telefoni dhe faksi	15,500.00 €	15,022.12 €	477.88 €	96.92
3	Shpenzimet e Ujit	1,500.00 €	1,148.04 €	351.96 €	76.54
	Totali	36,000.00 €	34,816.46 €	1,183.54 €	96.71

**Figura 18. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për komunalitet në vitin 2012**

Ne vazhdim është prezantuar tabela e projekteve kapitale

Tabela 24: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për Projekte Kapitale në vitin 2012

Nr. R.	Pershkrimi	Te Planifikuara	Te Shpenzuara	Diferenca	Ne %
1	Ndërtimi i 2 planshetave të hartës gjeologjike	80,000.00	71,500.00	8,500.00 €	89.4
2	Portable Multiparameter InstrumentspH/Oxi, pH	2,600.00	2,449.49	150.51 €	94.2
3	Licena per nevojat e GIS, Gjeologjise, Gjeodezi	30,000.00 €	29,579.55 €	420.45 €	98.6
4	Scaner A0	3,400.00		3,400.00 €	0.0
5	Avancimi i Geodatabases	120,000.00		120,000.00 €	0.0
6	VOP (Voice over IP) - Telefonia	25,000.00	24,947.47	52.53 €	99.8
7	Blerja e një GPS dhe Stacione total për matje	100,000.00	86,872.65	13,127.35 €	86.9
8	Pajisja me Laptopë	7,000.00	6,792.00	208.00 €	97.0
9	Blerja e pajisjeve ArcPad	2,000.00		2,000.00 €	0.0
10	Laser per matje ne distancë dhe thellësi	10,000.00	8,652.00	1,348.00 €	86.5
Totali per shpenzime Kapitale		380,000.00 €	230,793.16 €	149,206.84 €	60.7

Projekti Avancimi i Geodatabases, Ky projekt nuk ka mundur te realizohet në vitin 2012 për arsye se kompania e cila është edhe krijuese e kësaj Baze të të Dhënave (BEAK) nuk e ka dorëzuar kodin burimor. Kontesti në fjale është në procedurë të sqarimit që do të krijonte mundësi për përmbyllje të projektit.




Figura 19. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për komunalitetin në vitin 2012

Te Hyrat

Në tabelën e mëposhtme është prezantuar inkasimi i të hyrave për vitin 2012, sipas viteve

Tabela 25: Inkasimi i të hyrave për vitin 2012, sipas viteve

Pershkrimi	Kodi ekonomik	Total faturuar 2011	Inkasim për vitin 2012	Borxh 2012	Inkasim për vitin 2007/2008/2009	Inkasim për vitin 2010	Inkasim për vitin 2011	Inkasim për vitin 2012	Total 2012
a	b	c	d	e=c-d	f	g	h	i	l=f+g+h+i
Taksa Administrative	50019	256,531	345,885.19	- 89,354	21,605.20	10,339.97	114,917.02	199,023.00	345,885.19
Gjyba Administrative	50107	1,859,943	180,496.26	1,679,446	900.00	35,062.30	48,737.79	95,796.17	180,496.26
Renta Minerare	50203	7,351,254	5,887,153.74	1,464,100	105,718.76	153,260.65	2,106,933.51	3,521,240.82	5,887,153.74
Totali		9,467,727.87	6,413,535.19	3,054,192.68	128,223.96	198,662.92	2,270,588.32	3,816,059.99	6,413,535.19

Në tabelën e mësipërme, për vitin 2007 janë inkasuar 15,623.76 €, Taksa Administrative 4,800.00 €, Gjyba Administrative 0.00 € dhe Renta Minerale 10,823.73 €.

Për vitin 2008 janë inkasuar 18,288.52 € ose në taksa Administrative 4,485.20 €, Gjyba 0.00 € dhe Renta Minerale 13,803.32 €.

Për vitin 2009 janë inkasuar 94,311.68 € ose ne taksa Administrative 12,320.00 €, Gjoba 900.00 € dhe Renta Minerale 81,091.68 €.

Ne tabelën e me poshtme është prezantuar faturimi dhe inkasimi i te hyrave për vitin 2012

Tabela 26: Faturimi dhe inkasimi i te hyrave për vitin 2012

Nr. Ren	Pershkrimi	Kodi ekonomik	Te faturuara 2012	Inkasim për vitin 2012	Bilanci
1	Taksa Administrative	50019	256,531	345,885	- 89,354
2	Gjoba Administrative	50107	1,859,943	180,496	1,679,446
3	Renta Minerare	50203	7,351,254	5,887,154	1,464,100
	Totali		9,467,728	6,413,535	3,054,193




Figura 20. Faturimi dhe inkasimi i te hyrave për vitin 2012

Siç shihet ne tabelën e me sipërme mosrealizimi i faturimit ka ndodh ne kategorinë ekonomike gjoba administrative dhe renta Minerare.

Gjobat Administrative, KPMM-ja gjatë vitit 2012, ka pas një aktivitet te shtuar ndaj operuesve ilegal dhe me këtë janë përgatit nga departamenti i financave 164 raporte për operime ilegale dhe vlera e këtyre raporteve është 1,192,482.21 €, për vitin 2012, ndërsa diferenca prej 667,460.79 € është për operimet e viteve te me hershme por qe aktvendimet ju kanë lëshuar ne vitin 2012 po ashtu ne sistemin financiar te KPMM-ës është vendosur ne vitin 2012.

Te renta minerare siç shihet është një faturim me i madh se sa inkasimi për këtë vit, pra kemi te bëjmë me obligimet e Minierës se Trepçës.

Obligimet e Trepça-ve për vitin 2012 janë 744,847.85 €

Me 04.01.2013 Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerare ka aplikuar ne Agjencinë Kosovar te Privatizimit si kreditor i Trepça-ve, shuma e kreditimit është 2,813,466.64 €.

8. AKTIVITETET E TJERA

8.1. GIS-i (Sistemi i Informacionit Gjeografik)

Ne baze të nenit 56 pika 2.2. e Ligjit Nr 03/L-163 për Miniera dhe Minerale, KPMM është përgjegjës edhe për themelimin dhe mirëmbajtjen e një kadastrë të minierave dhe një Baze të Dhënave GIS, që përmban të dhëna gjeografike, gjeologjike dhe të dhëna të tjera relevante ekonomike si dhe të gjithë titujt ekzistues të mineraleve dhe të drejtave minerare.

Për të përmbushur këtë funksion Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) ka Sistemin Informativ të Menaxhimit (SIM), Geo-Databazën e Kosovës (SIM, GDK) si Kadastrë të minierave të Kosovës. GDK përkrah disa procese të punëve të KPMM-së, përfshirë menaxhimin dhe lëshimin e Licencave për Hulumtim, Shfrytëzim si dhe Lejeve për Punë të Posaçme.

Departamenti i GIS-it i ka proceduar në përputhje me ligjin në fuqi, të gjitha kërkesat e pranuar gjatë vitit 2012, ka vendosur të dhënat në Bazën e shënimeve dhe GIS, ku është bërë lidhja e të gjitha dokumentacioneve teknike për numër të kërkesë (ID-së), dokumente këto si; formulari i kërkesës, certifikata e regjistrimit, licencë të mëhershme për hulumtim, kopjet e planeve, listat poseduese, koordinatat, programin e xehetarisë, elaboratin gjeologjik, vlerësim të ndikimit në mjedis e tej janë vendosur në Bazën e të dhënave të KPMM-së.

Departamenti i GIS-it ka përdorur SIM, për nevojat e licencimit, të cilat janë parashtruar në KPMM gjatë vitit 2012. GIS ofruar informata ministrive dhe komunave të Kosovës, siç janë MZHE-i, MMPH etj, shënime me të cilat u kanë ndihmuar në hartimin e politikave zhvillimore dhe planifikimeve hapësinore.

8.2. GJEODEZIA

Aktivitetet e Departamentit të Gjeodezisë janë te paraqitura si me poshtë:

- Shqyrtimi i kërkesave për Licenca/leje:
 - Hulumtimit
 - Shfrytëzimit
 - leje për aktivitete te veçanta
- Matjet Gjeodezike ne teren:
 - Matjet e shfrytëzimeve te operimeve ilegale,
 - Matjet e shfrytëzimeve te operimeve te kompanive të Licencuara.
- Verifikimi i koordinatave te fushës për minim.

-Shqyrtimi i aplikacioneve për Licenca /Leje:

Për çdo aplikacion për licencë që i dorëzohet KPMM-së departamenti i gjeodezisë ka bërë shqyrtimin e dokumentacionit që i përket fushës nga gjeodezia siç janë : shqyrtimi i koordinatave me hartë te lokacionit, fletës poseduese, kopjes se planit, pëlqimeve si dhe situacionin e terrenit me rrjetin gjeodezik te matjes.

Pas verifikimit të lokacionit në terren, verifikimin e dokumentacioneve teknike, formulohet raporti me shkrim dhe rekomandimi për bordin e KPMM-së për kërkesën e caktuar.

Kjo formë e shqyrtimit e prezantuar më lartë aplikohet më qellim të zbatimit të plot të legjislacionit në fuqi dhe ka qellim që parregullsitë eventuale të eliminohen sa më pare që të jetë e mundur, sepse kështu parasheh edhe Ligji për Minierat dhe Minerale.

- Matjet Gjeodezike ne teren:

- Matjet te shfrytëzimet ilegale,
- Matjet te kompanitë qe janë të Licencuara.

Inspektoret e KPMM-se pasi qe te kenë evidentuar ne terren ndonjë operim ilegal e përgatisin raportin duke i rekomanduar Departamentin e Gjeodezisë qe te beje matjen e mineralit - resursit se shfrytëzuar ne mënyrë ilegale. Departamenti i Gjeodezisë brenda afatit te paraparë me ligj del ne terrene dhe benë matjen e mineralit - resursit se shfrytëzuar ilegale. Masat e shfrytëzuara i kalkulon me softuerët e pastaj përgatit raportin e masës se kalkuluar e të cilat dorëzohen ne zyrën e regjistrimit te KPMM-se për ti përcjell ne departamentet përkatëse.

Numri i matjeve te të cilat janë kryer për vitin 2012 që kanë operuar ilegalisht është njëzet e tri kompani. Sasia e përgjithshme e materialit te shfrytëzuar nga këto kompani është 278,912.16 m³.

Këto te dhëna për operuesit ilegal janë përdorur si baze për kallëzim penal dhe gjoba administrative.

Departamenti i gjeodezisë për veç matjeve te operuesve ilegale bene edhe matjen e operuesve legal (te pajisur me licence) për te verifikuar sasinë e shfrytëzuar, gjithashtu për çdo fund vit

bene verifikimin e masës së shfrytëzuar gjatë gjithë viti kalendarik për të gjithë operatorët e licencuar.

Numri i kompanive të cilat janë kryer matje të stokeve për vitin 2012 që kanë licencë rëre dhe zhavorre por që është dashtë të verifikohen është njëzet e shtatë kompani. Sasia e përgjithshme e materialit të shfrytëzuar nga këto kompani është 58,868.86 m³.

Pra pas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/46 datë 02.11.2011, kemi qenë të obliguar të të gjitha kompanitë e Licencuara të kryhen matje të stokeve të deponuara.

Matjet janë kryer me instrumente të avancuara dhe metoda adekuate, llogaritjet janë kryer me softuer të cilët i posedon KPMM-ja.

Verifikimi i koordinatave para çdo minimi

Pas aplikacionit për minim të kompanive inspektori i minierave del në terren për të verifikuar fushën e minimit, koordinatat e matura në terren inspektori i sjell në Departamentin e Gjeodezisë për të verifikuar se a është fusha e minimit brenda fushës së licencës së shfrytëzimit. Departamenti i Gjeodezisë përgatit një skicë të pozitës së fushës së minimit brenda licencës së shfrytëzimit.

8.3. DEPARTAMENTI LIGJOR

Në vitin 2012 Departamenti Ligjor i KPMM-së ka pasur një dinamik të madhe të punëve në përgatitjen e shumë vendime, përgatitjen e shkresave të ndryshme, udhëzimeve administrative, interpretimeve, këshillimeve juridike, përfaqësimeve para organeve gjyqësore, përfaqësimeve para organeve të Administratës Publike, përfaqësimin para Prokurorisë publike, Përfaqësimin para organeve të rendit.

I Gjobat Administrative

Departamenti Ligjor i KPMM-së ka përgatitur 197 Aktvendime për Gjopa administrative lidhur me operimet ilegale, duke e respektuar Qarkoren për operimet ilegale të datës. Vlen të theksohet se ka pasur një harmonizim të punëve me departamentet tjera për procedim të lendeve lidhur me operimet ilegale.

Si çështje tjetër e cila vlen të theksohet se raporti i matjeve në pajtim me nenin 79 paragrafi 3 edhe në këndvështrimin e dispozitave të Kodit Penal të Kosovës është kriter esencial lidhur me përcaktimin e përgjegjësisë.

Prandaj KPMM-ja pret se Gjykatat kompetente do jone azhure në zbatimin e Ligjit për Miniera dhe Minerale, dhe Aktvendimet e dërguara për Gjobat administrative të ekzekutohen sepse lendet që janë përcjellur janë të kompletuara me prova dhe faktet e duhura.

Shuma e tërësishme e këtyre Aktvendime për Gjopa administrative që KPMM-ja i ka përcjellur në Gjykatat kompetente është 1,449,044.16€

II. Çështja e Ankesave në KPMM

Për dallim nga vitet tjera viti 2012 ka shënuar progres të theksuar lidhur me përpunimin dhe shqyrtimin e ankesave. KPMM si organ administrativ i përmbahet rregullave lidhur me shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave ë ashtu si parashihet në ligjin për Procedurën Administrative. Departamenti ligjor ka përgatitur gjithsejtë **239** vendime lidhur me ankesat, parashtresat, kërkesat e palëve që i janë drejtuar KPMM-se.

Për të treguar efektivitet kompanitë në kryerjen e obligimeve financiare Bordi I KPMM-se ka marr vendim që të gjitha kompanitë që kanë kryer veprime ilegale e nuk i kanë kryer obligimet financiare ndaj KPMM-se nuk mund të licencohen nëse brenda afatit të caktuar nuk i kryejnë këto detyrime ligjore, kurse kompanitë të cila kanë licenca e nuk i kanë kryer obligimet financiare ndaj KPMM-se nuk do të lejohen të zhvillojnë aktivitetet minerar nëse brenda afatit të caktuar nuk i kryejnë këto detyrime.

III. Çështja e Përmbartimit ekzekutimit të gjobave administrative dhe vendimeve në përgjithësi të KPMM-së.

Procedura Përmbartimore është fazë e fundit për përfundimin e një procesi Gjyqësor apo administrativ. Është procedurë mjaft komplekse dhe e rëndë por duhet gjithsesi dhe jemi të obliguar që të vazhdojmë me procedimin e lëndëve nëpër gjykata.

Nga KPMM-ja në Gjykatat kompetente në vitin 2012 janë përcjell **81** Propozime për Përmbartim që në vete përmbajnë shumë aktvendime për Gjopa administrative. Ka pasur 1

propozim për Përmbarim në lëmin civile dhe ai propozim është ekzekutuar nga Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë (ekzekutimi lidhur me kompaninë Iter Travel Company

Shuma e tërësishme e propozimeve për përmbarim që KPMM-ja i ka përcjellur në Gjykatat kompetente është 744,918.20 €

IV. Kallëzimet Penale

Me parashtrimin e denoncimit penal nga KPMM-ja, Prokuroria Publike sipas detyrës zyrtare (ex officio) fillon hetimet për operuesit ilegal dhe gjatë gjithë procedurës KPMM duhet të bashkëpunoj me prokurorinë ti ofroj prova, fakte, sqarime, dëshmi etj.

Çështja e resurseve minerale është materie e re për Prokurorët e Kosovës dhe ka oscilime të ndryshme se si të përpunohet dhe me çfarë veprë penale të shkohet sipas kodit penal të Kosovës. Në momentin kur KPMM i dërgon prokurorit kallëzimin penal, prokurori nuk është i lidhur me kualifikimin juridik të veprës penale që i bënë parashtruesi i kallëzimit penal, në këtë rast KPMM-ja ai mund të ndryshoj komplet kualifikimin juridik të veprës penale sepse këtë të drejtë prokurorit ja jep Kodi i Procedurës Penale. Tani me hyrjen në fuqi të dy kodeve të reja Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit Penal të Kosovës ndryshon edhe qasje e KPMM-së e cila duhet të i përshtatet rregullave të këtyre dy kodeve. Neni 78 i kodit të Procedurës Penale 04/L-123, parasheh që organet publike janë të obliguar ti paraqesin të gjitha rastet për të cilat janë të informuar apo kanë dijeni se është kryer një veprë penale.

Në vitin 2012 janë përcjell 44 kallëzime penale në Prokurorit kompetente që kryesisht kanë të bëjnë me veprimet ilegale të shfrytëzimit të resurseve minerale të Republikës së Kosovës që sipas Ligjit për Miniera dhe Minerale janë pasuri e shtetit.

V. Mbledhjet e Bordit

Në vitin 2012 Bordi i KPMM-së ka mbajtur gjithsej 19 mbledhje dhe nga këto mbledhje janë përgatitur në tërësi vendimet si miratimi i aplikacioneve, kërkesave, ankesave, shqyrtimi i çështjeve të ndryshme e për të gjitha këto janë përgatitur vendime nga Departamenti Ligjor i KPMM-së .

Për të treguar efektivitetin kompanitë në kryerjen e obligimeve financiare Bordi i KPMM-se ka marrë vendim që të gjitha kompanitë që kanë kryer veprime ilegale e nuk i kanë kryer obligimet financiare ndaj KPMM-se nuk mund të licencohen nëse brenda afatit të caktuar nuk i kryejnë këto detyrime ligjore, kurse kompanitë të cilat kanë licencë e nuk i kanë kryer obligimet financiare ndaj KPMM-se nuk do të lejohen të zhvillojnë aktivitet minierar nëse brenda afatit të caktuar nuk i kryejnë këto detyrime.

VI. Përfaqësimi i KPMM-së në Gjykatë.

Në vitin 2012 ka pasur 100 përfaqësime të cilat Departamenti Ligjor i ka bërë duke e përfaqësuar KPMM, në Gjykatë, Prokurori, Polici, në organet e administratës publike.

Çështja e përfaqësimit të KPMM-se pranë Gjykatave është një çështje shumë me rëndësi aty behet ballafaqimi me palët të cilat kanë bërë shfrytëzim ilegal të resurseve minerale si dhe shkelje tjera ligjore kurse KPMM-ja ofron fakte dhe prova në mënyrë që gjykata të vendosë për dënimin e merituar.

Është me rëndësi të ceket shumica e denoncimeve tona penale vlerësohen nga Prokuroret dhe përfundojnë me akte akuzues

VII Licencat, Lejet për Aktivitete të Veçanta, Leje për Fillimin e Punëve Hulumtuese.

Departamenti Ligjor ka përgatitur gjatë vitit 2012 një numër të konsiderueshëm të licencave dhe lejeve:

Licenca te Hulumtimit	- 45
Licenca te Shfrytëzimit	- 40
Leje për Aktivitete të Veçanta	- 13
Leje për Fillimin e Punëve Hulumtuese	- 21

VIII. Paditë dhe Përgjigjejet në Padi

Si rezultat i punës dhe aktivitetit të KPMM-së në vitin 2012 Departamentin Ligjor ka përgatitur **29** Përgjigje në Padi të cilat janë dërguar në Gjykatën Supreme të Kosovës. Të gjitha përgjigjet në padi kanë të bëjnë me vendimet e Komisionit të Ankesave në kontestet administrative.

IX. Aktet nënligjore

Në vitin 2012 nga Departamentin Ligjor janë përgatitur dhe publikuar në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës **4 Udhëzime Administrative**.

Udhëzimet Administrative

1. (KPMM NR. 001/2012) Për Rregullat dhe Tarifat e Shërbimeve për palët e treta të kryera nga Arikva e KPMM. Publikuar me 15.03.2012
2. (KPMM NR. 002/2012) Për Dënimet Administrative dhe Dënimet Mandatore. Publikuar me 31.05.2012
3. (KPMM NR.003/2012) Për Blerjen, Ruajtjen dhe shpërndarjen e mallrave dhe Shërbimeve të kryera në KPMM). Publikuar me 31.05.2012
4. (KPMM NR. 004/2012) Për Rregullat dhe Tarifat e Shërbimeve për palët e treta të kryera nga Arikva e KPMM. Publikuar me 14.06.2012.

X. Të tjera

Departamenti ligjor përveç licencave dhe lejeve, akteve nënligjore dhe përgatitjen e vendimeve, gjatë vitit 2012 ka përgatitur shumë shkresa dalin nga detyrat dhe përgjegjësit e Bordit dhe Drejtorit duke përfshirë: 50 vërejtje për aplikacionet, 60 “Njoftime për Mospërputhshmëri”, 10 vendime për Licencat e rërës dhe zhavorrit, si dhe shkresa të ndryshme që dalin nga takimi i parabordit.

Për shkak të numrit të madh të ankesave të paraqitura në KPMM Komisioni Shqyrtues ka pasur një punë shumë voluminoze derisa ka pritur të dinamika e shqyrtimit të ankesave në kuadër të afateve ligjore .

Gjatë viti 2012 KPMM-ja ka pasur një bashkëpunim te shkëlqyeshëm me Komisionet Parlamentare te Kuvendit te Republikës se Kosovës .

Pasi qe është paraqitur nevoja e plotësimit te Ligjit për Miniera dhe Minerale ne këtë raste i është dhënë e mundësia qe edhe KPMM-ja te jep një kontribut ne lidhje me draftimin e këtij Ligji.

Duke pasur parasysh se KPMM-ja është Institucioni me i thirrur për zbatimin e Ligjit për Miniera dhe Minerale kemi pasur mundësin qe vështiruesit dhe vakumin ligjor qe i kemi hasur gjatë punëve te përditshme te i plotësojmë me rastin e takimeve se bashku me Komisionin Parlamentar për Zhvillim Ekonomik , Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, i cili me punën e tij te palodhshme ka mundësuar draftimin e këtij Ligji.

Vlen te ceket se bashkëpunim ne nivel te larte KPMM-ja ka edhe me Komisionet tjera parlamentare pasi qe se bashku janë bere vizita ne teren sa here është paraqitur nevoja.

Bashkëpunim ndërinstitutional ne punët e përditshme kemi pasur edhe me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe te gjitha Institucionet e tjera te Republikës se Kosovës.

Gjatë vitit 2012 Departamenti Ligjor është mar me zbatimin e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndërprerjen e shfrytëzimit te rërës dhe zhavorrit afër lumenjve .

Për shkak te mos përmbushjes së kushteve te licencës ne bazë të Ligjit për Minierat dhe Mineralet, gjatë vitit 2012 janë anuluar gjithsejtë 13 licenca.

8.4. ADMINISTRATA

Departamenti i Administratës në vete përmban Njësinë e Transportit dhe Logjistikës, Njësinë e Personelit si dhe Njësinë e Përkthimeve, me një staf prej 7 punëtorëve.

Sikurse viteve të mëparshme, edhe gjatë vitit 2012, Departamenti i Administratës është angazhuar që t'u japë përkrahjen administrative departamenteve tjera si dhe KPMM-së në tërësi, në mënyrë që punët profesionale të kryhen sipas planit të punës.

Njësia e Transportit dhe Logjistikës i ka në mbikëqyrje dhe është përgjegjës për 25 automjete. Gjatë vitit 2012, për shkak të amortizimit janë proceduar në ankand publik 3 automjetet Landrover. Organizimi dhe procesi i shitjes së këtyre automjeteve, konform procedurave ligjore, është bërë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Automjeteve iu është bërë servisimi dhe mirëmbajta me kohë, sipas intervaleve të duhura për servisim. Shumica e automjeteve janë të vjetruara dhe koeficienti i shfrytëzimit është shumë i madh, ku si rrjedhojë e kësaj, janë rritur shpenzimet e karburanteve si dhe shpenzimet për servisimin dhe mirëmbajtjen e këtyre automjeteve. Vlen të theksohet se nga 25 automjete zyrtare që ka KPMM, prej tyre 12 automjete të cilat kryesisht shfrytëzohen për aktivitete në teren i kanë më shumë se 12 vite shfrytëzim. Për shkak të amortizimit të këtyre automjeteve, gjatë vitit 2012 rreth 75% e shpenzimeve për mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve janë shpenzuar për këto 12 vetura.

Nga **Njësia Personelit** gjatë vitit 2012 janë kryer detyrat dhe përgjegjësitë konform ligjeve në fuqi për shërbyesit civilë. Janë realizuar 2 rekrutime, por në mungesë të mjeteve buxhetore nuk kanë mundur të realizohen edhe rekrutimet tjera konform numrit të aprovuar të pozitave për KPMM-në.

Po ashtu konform procedurave ligjore gjatë vitit 2012 është bërë edhe zgjedhja e Kryeinspektorit të Minierave sipas Ligjit për Minierat dhe Mineralet; si dhe emërimi Drejtorit të ri në KPMM, efektiv nga data nga 01.01.2013.

Vlen të theksohet se KPMM ka një personel me kuadër mjaft të kualifikuar, siç mund të shihet edhe në grafiku në vijim.




Figura 21. Paraqitja grafike e kualifikimit të personelit të KPMM-së

Gjatë vitit 2012, **Njësia e Përkthimeve** ka bërë përkthime nga gjuha serbe në atë shqipe dhe anasjelltas si dhe përkthime nga gjuha angleze në atë shqipe dhe anasjelltas të dokumenteve dhe shkresave elektronike të ndryshme. Sektori Gjuhësor gjithashtu ka bërë përkthime në takime zyrtare si dhe ka kryer punë të tjera administrative.

8.5. TEKNOLOGJIA INFORMATIVE

Departamenti i Teknologjisë informative gjate vitit 2012 ka realizuar disa nga projektet e parapara dhe te planifikuara për këtë vit. Ne përgjithësi mund te quhet si vit i suksesshëm, por qe me realizimin e projektit te Avancimit te Bazës se te Dhënave do te ishte shume me i suksesshëm, pasi qe te gjitha shërbimet e ofruara nga IT-ja kane qene ne funksion tere kohen dhe nuk ka pasur ndërprerje te asnjë shërbimi. Pra shërbimet e TI-se kane qene online 24 ore pandërprerë

Janë arritur objektivat e parashtruara si me poshtë:

- Ulja e shpenzimeve telefonike duke e realizuar projektin e VoIP-se (Voice Over IP)
- Ofrimi i shërbimeve për te gjithë te interesuarit për veprimtarinë e kompanive ne fushën e Minierave dhe Mineraleve,
- Ofrimi i informacioneve te nevojshëm përmes ArcGIS-it ne Web faqe për përbërjen minerale te fushave te ndryshme ne tere territorin e Kosovës,
- Ofrimi i informacioneve te nevojshme ne Portalin e jashtëm te KPMM-se për statusin e kompanive si dhe për veprimtarit qe ata ushtrojnë,

Janë realizuar **Projektet Kapitale** te parapara për këtë vit.

- ***Voice over IP (Telefonia përmes IP)***
- ***Furnizim me Licenca për përpunimin e projekteve te KPMM-se,***
- ***Furnizim me LapTop per Inspektoriat***

VoIP – Projekti i VoIP është realizuar edhe me mbështetjen e kompanisë **Amerikane ICITAP** e cila ka mbështetur institucionin tone për realizimin e këtij Projekti.

Janë ulur shpenzimet telefonike në mase te konsiderueshme, zaten kjo është edhe objektivi i Qeverise për uljen e shpenzimeve ne kategorinë mallra dhe shërbime, ne disa muaj kemi edhe ulje te shpenzimeve edhe ne përqindje edhe me te madhe. **Shpenzimet telefonike** kane rene nga **1200 € ne 550€** për muaj. Mund te themi lirisht qe jemi institucioni i pare qeveritar qe e përdorim këtë teknologji për uljen e shpenzimeve telefonike, çka kjo do te ishte edhe si shembull për institucionet e tjera qeveritare.

Furnizimi me Licenca (AutoCAD 2013) – Janë marr katër licenca për institucionin e KPMM-se si dhe një Server Licence Rrjetore (Network License), qe mundëson punën e tere stafit profesional me këtë program. Programi është instaluar tek te gjithë inxhinieret qe e përdorin aplikacioni e AutoCAD-it për realizim e detyrave te punës dhe u mundëson përpunimin dhe elaborimin e projekteve qe kompanitë i sjellin ne institucionin tone, çka një mundësi e tille nuk ka qene me herët për shkak te numrit te kufizuar te licencave për këtë program.

Pos furnizimit me licenca është bere edhe trajnimi i stafit për te përdorur këtë program dhe atë ne te dy nivelet dhe atë fillestar dhe te Avancuar.

8.6. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB), vazhdon me misionin e saj themelor, si aktivitet i pavarur këshillëdhënës, dhe i ofrimit të sigurisë objektive, i përcaktuar (projektuar) që të shtojë vlerat dhe të përmirësojë funksionimin e institucionit. Ai ndihmon institucionin në përmbushjen e objektivave të saja duke ofruar qasje sistematike, të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektshmërinë e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.

Raporti paraqet në mënyrë përmbledhëse fushat e audituara, aktivitetet e ndryshme të ndërmarra dhe sfidat e dala gjatë vitit 2012. Gjithashtu, raporti paraqet planet e përgjithshme për të ardhmen e Njesisë së Auditimit të Brendshëm në veçanti dhe Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale në përgjithësi.

Fushat dhe aktivitetet e audituara

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB), ka realizuar pesë aktivitete të auditimit dhe një me kërkesën e menaxhmentit, meqë rast NjAB, ka realizuar në tërësi Planin Vjetor për Vitin 2012. Janë nxjerr gjithsejtë 27 Te gjetura dhe 27 Rekomandime në mënyrë përmbledhëse, gjegjësisht 82 Te gjetura dhe 78 Rekomandime në mënyrë analitike.

Në vijim kemi paraqitur Raportet e përfunduara të auditimit për fushat e caktuara të parapara me Planin Vjetor 2013:

- ***Servisimi dhe Mirëmbajtja e Automjeteve-Hyundai Nr. Prokurimit: 318 12 001 236.***
- ***Shqyrtimi i Ankesave;***
- ***Auditimi i Logjistikes;***
- ***Marrëveshjet për Programimin e Pagesës së Rentës Minerare;***
- ***Menaxhimi i Automjeteve të Transportit;***
- ***Sistemi i Teknologjisë Informative.***

NjAB ka realizuar të gjitha angazhimet e planifikuara për auditim brenda kësaj periudhe. Përderisa janë mbajtur takime të rregullta konsultative me përfaqësuesit dhe përgjegjësit e aktiviteteve të audituara në funksion të zbatimit dhe rritje së efikasitetit të kontrollit dhe qeverisjes.

Aktivitetet tjera

Ndër aktivitetet e shumta të ndërmarra nga NjAB, Ne kemi veçuar disa nga aktivitetet e kryera:

- Brenda kësaj periudhe është bërë finalizimi i raportit të Auditimit të Jashtëm për vitin 2011, si dhe auditimi i parakohshëm si fazë e parë e auditimit të Raportit nëntëmujorë për vitin 2012 nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Ndërsa, në cilësinë e koordinatorit stafi i

NjAB-it, ka ofruar shërbimet e nevojshme në këtë proces, duke koordinuar punën dhe proceset e përgjithshme në mes të ekipit të Auditorit të Jashtëm dhe menaxhmentit të KPMM-së.

Do theksuar se sa i përket vlerësimeve të Auditorit të Jashtëm, në vazhdimësi kemi rritje të theksuar të performances në menaxhimin financiarë dhe rritje të nivelit të qeverisjes dhe kontrollit në përgjithësi;

- Janë përgatit dhe dorëzuar në Njësinë Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm (NjQHAB) brenda afatit të paraparë Plani Vjetor 2013 dhe Plani Strategjik 2013-2015, janë dorëzuar në NjQHAB raportet periodike dhe vjetor për auditimet e kryera dhe aktivitetet tjera të NjAB-it;
- Është përgatit Raporti Vjetor 2011 dhe për pjesën e parë të vitit 2012 i aktiviteteve të NjAB-it për Bordin dhe Drejtorin e KPMM-së;
- Janë përgatitur katër procesverbalet nga katër takimet e obligueshme të mbajtura nga Komiteti i Auditimit të KPMM-së;

8.7. PROKURIMI

Gjatë vitit 2012 departamenti i Prokurimit ka kryer gjithsejtë 43 aktivitete të prokurimit të cilat kanë rezultuar me nënshkrime të kontratave ndërsa vlera e shpenzimeve të këtyre kontratave është gjithsejtë 314,412.98€.

Në këtë numër të aktiviteteve nuk përfshihen disa aktivitete të prokurimit të cilat kemi zhvilluar procedura të prokurimit për këto mirëpo kanë dështuar për shkak të buxhetit të ulët që kemi pasur të planifikuar për vitin 2012 për këto aktivitete.

Aktivitetet të cilat nuk kanë rezultuar me kontratë (kanë dështuar) për vitin 2012 janë:

1. Furnizim me Skaner robotik
2. Furnizim me Skaner A0
3. Avancimi i Gjeodatabazes , ky projekt nuk ka mundur të realizohet në vitin 2012 për arsye se kompania e cila është edhe krijuese e kësaj Baze të të Dhënave (BEAK) nuk e ka dorëzuar kodin burimor.

Ne vijim do të paraqesim klasifikimin e aktiviteteve të prokurimit sipas kodit të procedurës së përdorur:

- 11 aktivitete me procedurë të hapur (vlera të mesme)
- 17 aktivitete me procedurë kuotuese (vlera të ulëta)
- 1 aktivitet me procedurë të negociuar (vlerë e ulët)
- 14 aktivitete me procedurë me vlerë minimale (vlera minimale)

Me gjerësisht mund të i referoni raportit vjetor për kontratat e nënshkruara publike të përgatitur sipas formës standarde për vitin 2012 i cili raport është dërguar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) me datë 11.01.2013.

9. PROBLEMET NË SEKTORIN MINERAR

Punën dhe aktivitetin e KPMM-së gjatë vitit 2012 e kanë përcjell disa vështirësi të cilat në raste të caktuara kanë ndikuar në efikasitetin e punës së këtij institucioni mjaftë të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës. Ndër problemet dhe vështirësitë më të theksuara gjatë vitit të shkruar për KPMM-së ishin:

a) Vështirësitë e jashtme:

Këto janë vështirësi dhe probleme që reflektojnë rrethanat jashtë institucionit të KPMM-së:

Shfrytëzimet ilegale dhe mosrespektimi i standardeve ambientale!

- Një prej shqetësimeve kryesore që është trashëguar nga vitet e mëparshme, për KPMM-në edhe gjatë vitit 2012 kanë qenë operimet ilegale të mineraleve ndërtimore. Konstatohet se një prej problemeve më të mëdha që po e rëndojnë punën dhe aktivitetin minerar në Kosovë janë operimet ilegale. Efektet negative që janë duke shkaktuar operuesit ilegalë janë të shumëfishta, duke filluar nga:

- o shkatërrimi i ambientit;
 - o konkurrenca jo lojale;
 - o ikja nga pagesa e rentës minerare dhe taksat tjera. Etj.
- Mosrespektimi i standardeve ambientale nga ana e kompanive të licencuara.
 - Mos marrja e masave adekuate për operuesit ilegal, nga ana e organeve që merren me zbatimin e ligjit, siç është paraparë me Ligjin për Miniera dhe Minerale.

Mos respektimi i Procedurave të Licencimit nga aplikuesit!

- Problem në vete gjatë procedimit të kërkesave për pajisje me Licencë dhe Leje nga aplikuesit është mungesa e njohurive profesionale nga ana e stafit Menaxherial të kompanive;
- Neglizhenca dhe mos përmbajtja e afateve të parapara nga Institucionet përkatëse (MMPH, APK, Komunat etj), për shqyrtimin e kërkesave për pëlqim, i cili është kusht për vazhdimin e procedurave për licenca dhe leje sipas Ligjit për Minierat dhe Minerale.

Koordinimi ndërinstitucional!

- Siç e kemi cekur edhe tek operimet ilegale, koordinimi ndërinstitucional është çelës për krijimin e rendit dhe implementimin e ligjit në sektorin minerar. Prandaj ne vlerësojmë se një koordinim i tillë përveç që është i domosdoshëm kërkon gatishmëri dhe përgjegjësi nga të gjitha subjektet e implikuara që t'i harmonizojmë veprimet në mënyrë që të kemi efektet e dëshiruara në zbatim të ligjit.
- Problemi i cili na shqetëson shumë, është mos efektiviteti i kallëzimeve penale të ngritura nga KPMM-ja për operuesit ilegalë.

b) Vështirësitë financiare:

Këto janë vështirësi dhe probleme që lidhen me disponueshmërinë e burimeve të nevojshme financiare

Mos realizimi i buxhetit të planifikuar!

- Mos efikasiteti në realizimin e të hyrave, gjegjësisht mos rritja e nivelit të të hyrave në raport me faturimet kryesisht nga kategoria e Gjobave Administrative, të cilat janë në procedurë të përmbarimit.
- Mos raportimi dhe deklarimi i sakte i sasisë së mineralit të shfrytëzuar respektivisht obligimeve financiare dhe mos respektimi i afateve të përcaktuara, për të cilat janë ndërmarr masa adekuate në evitimin e këtyre dukurive;
- Mos realizimi i projekteve të rëndësishme kapitale për shkak të mungesës së buxhetit dhe pengesave administrative dhe të drejtave të mbrojtura për shfrytëzimin e sistemeve të caktuara;
- Mungesa e buxhetit për kategorinë e pagave dhe mëditjeve në raport me numrin e stafit të aprovuar për rekrutim.

c) Vështirësitë operative:

Këto janë vështirësi që ndikojnë në efikasitetin dhe efektivitetin e punës së KPMM-së në përgjithësi

Mungesa e procedurave dhe sistemeve adekuate!

- Vështirësitë gjatë ndërmarrjes së aksioneve për konfiskimin e mekanizimit të rëndë ndaj Operuesve Ilegal;
- Pengesat dhe sfidat e stafit gjatë kryerjes së detyrave në punë
- Mos avancimi i sistemit të teknologjisë informative siç është “Avancimi i Bazës së të Dhënave”, i cili mund të rrezikohet për shkak të skadimit të afatit të mbështetjes nga kompanitë Microsoft dhe ESRI për shkak të daljes së produkteve të reja (SQL 2000 tani SQL 2012 dhe ArcGIS 8.3 tani është ArcGIS 10);

Mungesa e objektit të përhershëm për zyrë

- Buxhetit të Kosovës shpenzimet e qeras për akomodimin e stafit të KPMM-së deri më tani i ka kushtuar mjaft shumë. KPMM që nga themelimi është i akomoduar në objekte private;
- Menaxhmenti i KPMM-së, vazhdimisht ka kërkuar me shkrim dhe verbalisht me të gjitha institucionet relevante për gjetjen e mundësisë së vendosjes në një objekt shtetëror, i cili do të na mundësonte vendosje të përhershme. Me gjithë faktin e angazhimit tonë vazhdojmë të jemi një ndër institucionet e pakta që nuk na është bërë ende zgjidhje në këtë aspekt. Me kontratën e re për qera, gjatë vitit 2012 është reflektuar një rritje e shpenzimeve për këtë kategori, për kundër që në vitin 2011 kemi pasur ulje të shpenzimeve të qerave.

10. SYNIMET PËR TË ARDHMEN

a. Rritja e koordinimit ndërinstitutional

Rritja e bashkëpunimit ndërinstitutional është i domosdoshme për të arritur respektimin dhe zbatimin e ligjeve dhe standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare për fushën e minierave dhe mineraleve. Efikasiteti i punës së KPMM-se varet nga përkrahja dhe bashkëpunimi ndërmjet KPMM-së dhe institucionet tjera përkatëse siç janë: Prokurorive-MD, policisë-MPB-së, MMPH-së, APK-së, Agjencia për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, komunat etj.

b. Ndalimi i operimeve ilegale dhe ngritja e kualitetit të punës dhe sigurisë në punë të kompanitë e licencuara

Ndër synimet kryesore të KPMM-së, është vazhdimësia e rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit në ndalimin dhe parandalimin e operuesve ilegale në sektorin minerar. Ndonëse rezultatet tona për luftimin e kësaj dukurie nuk mungojnë. Gjatë vitit 2012, janë bërë hapat më të mëdhenj deri tani. Pra për ndalimin e operatorëve ilegal, për çka janë bërë 12 konfiskime të mekanizimit të rënd. Janë bërë me qindra dënime me gjoba si dhe ndëshkime tjera. Për vitin 2013 do të vazhdohet edhe me intensitet më shtuar. Për me qenë këto aktivitete të suksesshme duhet pasur mbështetjen edhe nga institucionet tjera, sepse pa një punë të përbashkët dhe gjithë vepruese nuk mund të kemi rezultate të duhura.

Megjithatë ne konsiderojmë se duhet angazhim dhe trajtim me i veçantë për këtë dukuri. Gjithsesi luftimi i kësaj dukurie varet nga mbështetja dhe përkrahja e të gjitha strukturave vendimmarrëse në nivel vendi.

c. Përafrimi dhe harmonizimi i standardeve teknike me ato evropiane

Ne koordinim dhe ne përputhje me misionin dhe objektivin strategjik të Republikës së Kosovës për Integritet Evropian, KPMM ne kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të saj do të inicioj rishikimin dhe harmonizimin e legjislacionit vendor me standardet dhe praktikën me të mira Evropiane për sektorin minerar.

d. Rritja e inkasimit të të hyrave nga renta minerare dhe zvogëlimi i llogarive të arkëtueshme

